



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË



RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Planifikim Territori dhe GIS”.**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti POLIS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Gjergj Thomai 
2. Dr. Elvan Dajko 

Maj / 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS”.

ofruar nga Universiteti Polis

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Polis
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit Urban
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master profesional ne Planifikim Territori dhe GIS
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 376, datë 23.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikël i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1.5 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të zgjatur
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 / 3
18	Numri i studentëve:	31
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimeve Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS është riorganizuar me Urdhër të MASR Nr. 376, 23.09.2021 në një program të ciklit të dytë, që realizohet në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike (3 semestra) dhe me 60 kredite (ECTS).

Ky program është rrjedhojë e Programit 2-vjeçar me 90 kredite Master Profesional në “Politikat e Zhvillimit të Territorit” me tre profile: a) Planifikim Hapësinor dhe Aplikime GIS b) Strehim dhe Zhvillim Tokë c) Zhvillim Social Urban dhe Burime Njerëzore. Duke marrë parasysh historikun e themelimit të këtij programi, dinamikat ligjore si dhe ato të tregut të punës, por dhe eksperiencën që Universiteti POLIS ka fituar përgjatë viteve që ka bashkëpunuar me Institute for Housing and Urban Studies / Erasmus University, Hollandë, programi Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS” u riorganizua në një program të ciklit të dytë, që realizohet në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të zgjatur, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike (3 semestra dhe me 60 kredite (ECTS), në përfundim të së cilit lëshohet diplomë **“Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS”**.

Megjithatë programi zhvillohet në gjuhën shqipe, anglishtja është thuhetse gjuhë e dytë zyrtare që ka ndikuar për komunikim më të mirë me stafin e huaj, për ofrimin e leksioneve të hapura me profesorë të huaj dhe për ndërkombëtarizimin e shkollës.

Programi i studimeve **Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS** ofrohet nën përgjegjësinë kryesore të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMMU), pranë njesisë bazë-departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban, por për ofertën akademike angazhohen edhe pedagogë nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit (FAD), si edhe pedagogë nga universitete të huaja partnerë, kryesisht nga IHS / Erasmus, TU Wien, Universiteti i Ferrarës, etj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës

Përbërja e GVJ: Bordi Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilesisë në Arsimin e Lartë vendosen si ekspertë të jashtëm për këtë program, Dr Gjergj Thomai dhe Dr Elvan Dajko. Kordinatore Teknike e ASCAL për këtë program është Zj. Endra Velaj

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit. Gjatë vizitës së kryer në Universitetin POLIS, në datat 23-24 shkurt 2023 u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të ekspertëve të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit POLIS, stafit dhe studentëve të angazhuar në këtë program. Mbështetur në dokumentacionin e sipërpërmendur, kontaktet me stafin akademik e studentet si dhe kontrollin fizik të dokumentacionit pranë institucionit, GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Krahas takimeve e konsultave të evidencave të ndryshme, u zhvillua dhe një tur për të parë infrastrukturën. Në përfundim u hartua Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Më datë 02.05.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 48/13 Prot., datë 02.05.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 04.05.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 371/23 Prot., datë 04.05.2023, institucioni ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formën përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Planifikim Terriori dhe GIS

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Mbështetur në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues të tij në të cilin vecojmë Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit, misioni i Universitetit POLIS formulohet si: <i>Ofrimin ekselence në edukimin e profesionisteve dhe kërkueseve shkencore të aftë për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij. Të pajise studentët me cilësi të lidershit profesional në fushat që mbulon në mënyrë që të ushtrojnë influence për zhvillim pozitiv të vendit dhe rajonit, të kryejnë aktivitete kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura me veprimtaritë akademike në programet e studimeve, aftësi dhe njohuri teorike dhe praktike sipas standardeve më të larta bashkëkohore.</i> Duke pas parasysh historikun e zhvillimit urban të vendit dhe nevojën në rritje për mirë-administrimin e territorit, programi “Master profesional në Planifikim terriori dhe GIS” gjykojmë që plotëson kriteret e këtij standarti duke qene në përputhje e në ruajtje të interesave kombëtare, konsolidimin e vlerave akademike e kulturore të vendit dhe në përputhje edhe me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit dhe të BE. Veprimtaria e IAL lidhur me synimin e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare përveç tjerash dëshmohet edhe me marrëveshjet e bashkëpunimit e arritura nga Universiteti me institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare. <i>RVB: Strategjia e Zhvillimit, Aneksi Nr.2;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në RVB dhe evidencat shoqëruese, vizitës në terren dhe kontrollit të dokumentacionit rezulton se Programi i studimit Master Profesional në Planifikim Terriori dhe GIS është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, sipas përcaktimit të këtyre të fundit në Statutin e Universitetit dhe Strategjinë e Zhvillimit. Objektivat dhe veprimtaritë formuese sipas se cilave është organizuar programi i studimit janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me objektivin e krijimit të ekspertëve të kualifikuar në fushën e GIS dhe duke plotësuar nevojat e tregut të punës për këtë profesion. <i>RVB: Aneks 6-Rregullorja e programit, Aneksi Nr.1, Statuti</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për	Universiteti POLIS ka në fuqi Strategjinë e Zhvillimit 2021-2026. (http://www.universitetipolis.edu.al; strategy2021-2026.pdf). Gjithashtu në rregulloren didaktike përcaktohet si objektivi konsolidimi

<p>zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>i programeve ekzistuese të studimeve, duke synuar mbajtjen e tyre të përditësuar me kërkesat nga tregu i punës në vend (nëpërmjet feedback-ut nga të diplomuarit, institucionet partnere, ekspertet, etj) si dhe me atë tregun ndërkombëtar. Bazuar në këtë dokument dhe statistikën e dorëzuar për këtë qëllim, gjykojmë se programi i studimit është në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>RVB: Aneks 6-Rregullorja e programit</i></p>						
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prioritetet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Në organizim dhe përmbajtje programi i studimit është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit dhe akteve tjera juridike të miratuara nga IAL për organizimin e programeve të studimit VKM 41, amenduar nga VKM 389 / 2019. Përmbajtja e kurrikulës në nivel lëndësh por dhe nga konsultimi më në detaje të syllabuseve për secilën lëndë, vërehet një gërshetim i mirë i njohurive dhe temave me relevancë ndërkombëtare të planifikimit por dhe lëndë me fokus më të madh në kontekstin shqiptar. Strategjia e hartuar e IAL-së synon përmirësimin e vazhdueshëm dhe konsolidimin e kurrikulave ekzistuese. Diversiteti i ofertës akademike dhe edukimi dual si ndërlydhje e kërkimit dhe mësimdhënies janë kritere që janë marrë në konsideratë edhe për hartimin edhe zhvillimin e programit të studimit Master Profesional në Planifikim Terriori dhe GIS. Anëtarësimi dhe pjesëmarrja aktive e POLIS në rrjetin e shkollave europiane të planifikimit – AESOP bën që Universiteti të jete i mireinformuar me zhvillimet më të reja lidhur me çështjet e edukimit në fushën e Planifikimit të terriorit dhe GIS, të cilat me pas materializohen edhe në kurrikulat e programeve mesimore respective.</p> <p><i>Aneks 6-Rregullorja e programit</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vërteton se këto dokumente janë të artikuluar qartë dhe në koherencë me njëri tjetrin duke përfshi të gjithë spektrin e veprimtarisë akademike dhe funksionale duke ju referuar Programit të studimit Master Profesional në Planifikim Terriori dhe GIS i cili zhvillohet dhe organizohet në përputhje të plotë nga objektivat, misionit dhe vizionit Institucional.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar persa i përket kapaciteteve ofruese të programit, Institucioni i nënshtrohet një</p>

<p>në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>verifikimi të përvitshëm nga ministria e arsimit, që vlerëson si kapacitetet akademike (njerëzore) ashtu dhe ato infrastrukturore. Akreditimi periodik IAL Universiteti “POLIS” me vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL nr. 113 të datës 15.12.2017 është për 6 vite (14.12.2023). IAL ka brenda saj tri fakultete dhe një qendër. Nga dokumentacioni i më sipërm vërtetohet e Universiteti POLIS ka një organizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm Institucional duke filluar nga themelimi i tij. IAL ka të krijuara organet ekzekutive të sajë si dhe organet kolegjiale përmes së cilave sigurohet një hierarki e marrjes së vendimeve si dhe zbatimin e tyre. Në funksionimin e njësive akademike, Fakulteteve departamenteve ndihmojnë Statuti i Universitetit, si dhe rregulloret e brendshme të cilat sigurojnë një mbarëvajtje Institucionale pa zbrastësira. Departamenti që ofron programin e studimit të masterit profesional në planifikim territori e GIS ka 16 anëtarë më kohë të plotë nga të cilët 11 janë me tituj dhe grada, kurse në lidhje me infrastrukturën, institucioni disponon bibliotekën, laboratorë, lab mjedisi, lab të efijencies së energjisë dhe plotëson më së miri kërkesat për ta ofruar program me një cilësi të lartë. Kapacitetet fizike të IAL për numrin e studentëve janë brenda standardeve.</p> <p><i>RVB, Aneks 15, organigrama, Aneks 17 –Broshura IF,</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS ofrohet nga njësia kryesore Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, në përberje të njësive baze, Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit Urban. Në këtë kuptim ka një përputhje shumë të mirë në mes të fushës së programit të studimit dhe të dy njësive përgjegjëse.</p> <p><i>RVB, Aneks 5, Rregulloret e Fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit përkon me kodin “0731 Architecture and town planning” sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED dhe përputhet me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit dhe departamentit që e ofron. Fushat specifike të programit të studimit janë me përmbajtje shumë profesionale të aseteve shkencore të cilat i japin karakterin e veçantë studentit, pas përfundimit të studimeve. Programi i studimit Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS ofrohet si program me 60 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave (3 semestra) është e ekuilibruar dhe realizohet brenda një periudhe kohore prej 1,5 vite. Programi përfshin domosdoshmerisht praktikën profesionale dhe provimin përfundimtar dhe pas përfundimit të studimeve studenti merr diplomën me titull Master Profesional në planifikim dhe GIS me 60 ECTS.</p>

Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	N/A		
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Studentet e diplomuar nga programi i studimeve Master Profesional ne Planifikim territori dhe GIS kane mundesi per zhvillimin e trajnimeve per kualifikime pasuniversitare të mëtjshme me focus ceshtjet praktike në fushat e planifikimit fokusuar sidomos në zotërimin e dijeve më të avancuara në programet kompjuterike që aplikohen në fushën e planifikimit. <i>RVB dhe shenimet nga takimet me studentet</i>		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se IAL ka kapacitete të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit Master Profesional ne Plaifikim Terriori dhe GIS.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti POLIS ka të ndërtuar nje skemë organizative eficente duke i përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e njësive akademike, zyrove brenda institucionit si dhe pjesës së administratës së Universitetit. RVB e përpiluar përshkruan marrëdhëniet e mira ndërmjet administratës së Universitetit, zyrove brenda saj si dhe personelit akademik pa përjashtuar dhe Studentët të cilët janë pjesëmarrës aktiv. Pavarësisht se programi i studimit zhvillohet pranë njërës prej njësive bazë të Fakultetit – Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit, në mesimdhënie angazhohen dhe njësi të tjera bazë brenda dhe jashtë njësisë kryesore – si p.sh. Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë por dhe njësitë kërkimore – sidomos Njësia Kërkimore e Qëndrueshmërisë. Nga takimi me drejtuesit e Fakultetit, Departamentit si dhe me stafin akademik GVJ konstaton se secila njësi është e qartë për përgjegjësitë respektive. <i>RVB; Aneks Nr.33</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie	Në RVB dhe dokumentacionin shoqërues listohen organizmat me të cilat U_POLIS ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit. Diversiteti i këtyre partnereve (nga sektori

bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	publik dhe privat), por dhe institucione homologe të huaja garantojnë arritjen e objektivave të programit të studimit për pajisjen e studenteve me njohuri bashkëkohore në fushën e planifikimit të territorit dhe aftësimin e tyre praktik. Sa më sipër doli qartë dhe në bisedën me studentet e programit. <i>RVB; Aneksi Nr.32</i>						
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	U_POLIS raporton të këtë më shumë se 20 marrëveshje të posaçme, një pjesë e këtyre marrëveshjeve ishte depozituar para vizitës së GVJ në institucion, kurse një pjesë tjetër u verifikua gjatë intervistës. Organizimi i praktikave lëndore e profesionale (internships) është element i pranishëm në të gjitha marrëveshjet me institucionet publike dhe kompanitë private. Per kete program studimi duhet vene ne dukje fakti qe pjesa me e madhe e studenteve janë në marrdhënie pune dhe prandaj dhe praktikat profesionale i kryejne në vendin e punes, por këto marreveshje janë shumë të rëndesishme dhe eficente për studentet qe nuk jane ne marrdhenie pune dhe gjithashtu edhe për studentët e programeve të tjera të FPMMU. <i>RVB; Aneksi Nr 45</i>						
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në kuadër të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të institucionit (i cili depozitohet pranë MAS, por dhe garanton transparence e IAL me palët e treta), çdo departamenti i kërkohet të hartojë raportin e vet, pjesë e të cilit është edhe vlerësimi i bashkëpunimit me institucionet partnere. Ndërsa U_POLIS ka të miratuar strategjinë e zhvillimit e cila ka synim ndërkombëtarizimin e Institucionit. <i>Aneks Nr.3; Aneks Nr.52;</i>						
Konkluzione	<i>Në përmbldhje GVJ konstaton se institucioni, ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të realizimit me sukses të këtij programi studimi.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1



Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS” është program i ciklit të dytë të studimeve në përfundim të së cilit studenti pajiset me Diplomë “Master Profesional”, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe bazuar në sistemin e Bolonjës. Programi ka një strukturë e cila përmban 9 lëndë ku përfshihet Praktika Profesionale, Labororë dhe Provimi Përfundimtar. Caktimi i krediteve ECTS për secilën lëndë është vendosur në përputhje dhe zbatim me Udhëzimin e MAS nr. 1, datë 14.01.2020, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS” nëse plotësojnë 60 kredite sipas sistemit ECTS.</p> <p><i>RVB, Aneks Nr. 42, Matrica e Programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi ka një qasje të fortë ndaj praktikës ndaj dhe programi synon të formoje profesionistë të cilët do punojnë ngushtë me sistemet gjeografike të informacionit. Programi ruan një balance të mirë midis koncepteve teorike dhe atyre praktike si mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave, impaktin në shkallët ndryshme të planifikimit dhe se si adresohen këto duke përdorur sistemet gjeografike të informacionit. Këto objektiva reflektohen në rregulloren e programit mësimor. Në këtë program studimi, mësimdhënia është e kombinuar me veprimtari formuese integruese dhe praktike, workshop-e, tryezave të rumbullakta, seancave të debateve, vizita në institucione të rëndësishme. Labororët janë një tjetër instrument për të stimuluar punën në ekip të studenteve. Studentët të diplomuar në këtë program aftësohen të punësohen në bashki si ekspertë të sistemeve gjeografike të informacionit; në agjenci rajonale si ekspert të zhvillimit të qëndrueshëm territorial; në NGO dhe OJF, si ekspertë dhe këshilltarë; apo dhe në kompani të ndryshme ku njohuritë mbi formën e mbledhjes, menaxhimit dhe përpunimit analitik të të dhënave janë të domosdoshme; si edhe në studio të ndryshme të projektimi urban dhe territorial</p> <p><i>RVB, Aneks 6: Rregullore e Programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020, programi Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS” përmban veprimtaritë formuese të grupuara në disiplina si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A – lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme me 6 kredite;



	<ul style="list-style-type: none"> • B - lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore me 24 kredite; • C - lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje me 18 kredite; • D - lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale me 6 kredite; • E - detyrime përmbyllëse me 6 kredite; <p>Në kuader të praktikës profesionale, ky program përfshin lëndë në formën e studiove, workshop-ve apo seminareve, me profile të ngjashme të cilat një profesionist i ri të programit SPG mund të bashkëpunojnë me kolegë të planifikimin urban, arkitektit apo të menaxhimit urban. Këtu mund të përmendim studion e Urban Laboratory (Laboratorit Urban) që synon bashkëpunimin midis arkitektit dhe planifikuesit dhe SPG brenda një konteksti urban; Laboratorin e zgjidhjeve mjedisore me SGI e cila bashkon studiuesit e planifikimit hapësinor dhe sistemeve gjeografike të informacionit me studiuesit mjedisor në një kontekst urban dhe rural i cili duhet adresuar nëpërmjet Multicriteria Analyses me GIS etj.</p> <p><i>RVB, Aneks Nr.7 Rregullore Diplomimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë</p>	<p>NA</p>

realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.									
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Aktet nënligjore për kodifikimin e programeve të studimit nuk janë akoma në fuqi								
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Aktet nënligjore për kodifikimin e programeve të studimit nuk janë akoma në fuqi								
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS ofrohet si një program i pavarur dhe i ofruar plotësisht nga U_POLIS, që nga viti akademik 2021-2022, ashtu sikunder është shprehur nga institucioni edhe në kërkesën e ri-organizimit të këtij programi edhe si rrjedhojë e konsolidimit të përvojës së përfituar ndër vite.								
Konkluzione	<i>Nga sa më sipër GJVJ, konfirmon se ky program studimi, realizohet në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, si edhe me aktet rregullatore të vetë institucionit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësitë, departamentet dhe njësia e kërkimit përmbushin të gjitha detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Më konkretisht njësia kryesore është Fakulteti që kryesisht bashkërendon mësimdhënien, kërkimin dhe zhvillimin kulturor. Gjithashtu vlerësohet se Fakulteti është ai që ofron programe studimi të niveleve të studimit dhe në përfundim diplomë sipas programit të studimit. Fakulteti është organizuar në njësi bazë dhe ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër kërkimore. Nga ana tjetër është Fakulteti ai që miraton kriteret e

	<p>pranimi të studentëve, bazuar në propozimet e njësive bazë, por dhe përcaktimeve të ligjit në fuqi dhe akteve të tjera. Fakulteti drejtohet nga Dekani dhe ky i fundit miratohet nga rektori. Ndërkohë është Departamenti njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Sa i përket përbërjes, vihet re se Departamenti ka 16 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë dhe 11 prej tyre janë me grada shkencore. Gjithsesi Departamenti ka dhe staf ndihmës akademik. Si njësi bazë Departamenti përveçse përgjegjës për programin e studimit, propozon kriteret, numrin e studentëve dhe kriteret për pranimin e tyre. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe emërohet nga Rektori. IAL ka të themeluara edhe disa nga organe kolegjiale të cilat sigurojnë funksion të mirë të Institucionit sikur janë këshilli i etikës, këshilli i profesorëve, NJSBC, Zyra e këshillimit për studentët dhe Zyra e karrierës.</p> <p><i>RVB; Aneks Nr.1</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga RVB dhe takimet vihet re se stafi akademik angazhojnë studentët në punën kërkimore-aplikative, konferenca dhe aktivitete të tjera. Një vend të veçantë zë dhe puna në laborator, për çka është një staf i dedikuar, drejtuar nga përgjegjësi i laboratorit dhe stafi ndihmës, që nga pritësi i mostrave deri tek laborantët dhe ndihmës laborantët. Universiteti Polis ka ngritur 7 laboratorë, nga të cilat Laboratori i CAD, Laboratori GIS, Laboratori i Mjedisit dhe Observatori i pellgut të Mesdheut, menaxhohen nga Fakulteti i PMMU-se. Programi Master professional ne Planifikim Territuori dhe GIS, gjithashtu merr asistencë nga “Innovation Factory” strukturë ndërdisiplinore në Universitet, por ka dhe marrëveshje të ngushtë më një sërë laboratorësh jashtë Universitetit. Gjatë vizitës së GVJ në takimet me studentët konstatuam se praktika mësimore udhëhiqet nga personeli akademik i departamentit. Gjithashtu edhe ushtrimet laboratorike në ambientet e Universitetit udhëhiqen nga stafi akademik ndihmës.</p> <p><i>RVB; Aneks Nr.32</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinatori është pjesë e rëndësishme për një program studimi dhe si të tillë në Universitetin POLIS janë staf akademik punësuar me kohë të plotë. Koordinatorët realizojnë takime periodike me stafin dhe drejtuesin e departamentit. Koordinatori ndan në mënyrë periodike me drejtuesin e njësisë çdo informacion që lidhet më programin e studimit dhe ndërkohë vihet re se dokumenton në mënyrë të rregullt këto ndryshime. Koordinatori i programit të studimit jep llogari Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit lidhur me shqetësimet e studentëve për realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr.33</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konkludon se insitucioni ka mjetet, infrastrukturën dhe burimet njerzore të mjaftushme, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, me qëllim realizimin me sukses të programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi Master Profesional në Planifikim Teritori dhe GIS, është një program i ciklit të dytë, që realizohet në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të zgjatur, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike (3 semestra dhe me 60 kredite (ECTS)), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional në “Planifikim Teritori dhe GIS”.Njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për këtë program studimi në bashkëpunim me departamentet si dhe njësitë administrative disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit, objektivat dhe standartet të cilat janë të mirë përcaktuara dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.Plani mësimor është përcaktuar në formë vjetore, ndërsa kurrikulat janë objekt i rishqyrtimit periodik nga personeli akademik dhe në përputhje me procedurat përkatëse ndryshimet kalojnë procesin e miratimit nga Senati Akademik. Programi mësimor përcakton lëndën, modulën, profesorin, asistentët e lëndës, orët totale, ndarjen e orëve dhe kreditet përkatëse për çdo kategori, formën e vlerësimit dhe ndarjen javore të lëndëve. <i>RVB, Aneks Nr.4</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar dhe në Rregulloren Didaktike, Master Profesional në “Planifikim Teritori dhe GIS”, përmban 9 lëndë të cilët përfshijnë internshipin profesional si edhe provimin përfundimtar. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra. Ky program, nga kendveshtrimi përmbajtesor- i kushton vëmendje të veçantë mënyrës së organizimit dhe ofrimit të kurrikulës si nje balancim i qartë midis teorisë dhe praktikës, punës me projektet çka kërkon krijimin e punës në grup jo vetëm nga ana e studentëve por dhe e stafit të angazhuar në këtë program.Lëndët dhe modulet e programit janë të organizuara ndërmjet teorisë dhe praktikës, bazuar në projekte dhe punës laboratorike. Plani mësimor përcaktohet në formë vjetore, kurrikulat janë objekt i rishqyrtimit periodik nga personeli akademik dhe në përputhje me procedurat përkatëse, ndryshimet kalojnë procesin e miratimit nga Senati Akademik. Programi mësimor përcakton lëndën, modulën,

	profesorin, asistentët e lëndës, orët totale, ndarjen e orëve dhe kreditet përkatëse për çdo kategori, formën e vlerësimit dhe ndarjen javore të lëndëve. <i>RVB, Aneks Nr.4, Aneks Nr 42, Aneks Nr 6</i>						
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga RVB dhe dokumentacioni shoqerues konstatojme se Programi i studimit Master Profesional ne Planifikim Territori dhe GIS përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.						
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Pranë departamenteve ofrohet informacioni për programet, modulet dhe syllabuset, në formën fizike dhe elektronike. Përmbatja e syllabusit është e rregulluar në bazë të VKM 41, date 24.01.2018 (i ndryshuar). Kjo formë është reflektuar edhe në platformën e vlerësimit të sistemit të brendshëm PITAGORA. Të gjitha këto detaje në lidhje me organizimin e programit të studimit janë të miratuara dhe paraqitura çdo vit akademik në Planin Mësimor, Rregulloren Didaktike dhe Rregulloren e Programit të Studimit. <i>RVB, Aneks Nr.4, Aneks Nr 42, Aneks Nr 6</i>						
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Plani mësimor përcaktohet në formë vjetore, kurrikulat janë objekt i rishqyrtimit periodik nga personeli akademik dhe në përputhje me procedurat përkatëse, ndryshimet kalojnë procesin e miratimit nga Senati Akademik. Programi mësimor përcakton lëndën, modulin, profesorin, asistentët e lëndës, orët totale, ndarjen e orëve dhe kreditet përkatëse për çdo kategori, formën e vlerësimit dhe ndarjen javore të lëndëve. <i>RVB, Aneks Nr.4, Aneks Nr 42, Aneks Nr 6</i>						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se materialet e ofruara, takimet me studentët dhe pedagogët dëshmojnë për angazhim maksimal të Departamentit për zhvillimin e programit të studimit. Për funksionimin e programit të studimit departamenti bazohet në respektimin e akteve ligjore dhe rregulloreve të Universitetit. Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënie në këtë program studimi..</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja, objektivat, vizioni dhe standartet e përcaktuara programin Master Profesional në “Planifikim Teritori dhe GIS” janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit në lëndë/module dhe shpërndarja në semestra me orët dhe kreditet mësimore të ofruara nga ky program janë në përputhje të plotë me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve dhe bazës ligjore për arsimin e lartë. Mbeshhtetur në planin mësimor të shpërndarjes së lëndëve në tre semestra, programi Master Profesional në “Planifikim Teritori dhe GIS” ka për qëllim pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi bashkëkohore praktike për punë të pavarur për të përballuar kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë programi synon të garantojë një master teoriko-profesional studimi cilësor për të stimuluar krijimin e një elite profesionale-shkencore në vend, që gjeneron progresin e prekshëm ekonomik-social-shkencor në fushat e planifikimit hapësinor, qeverisjes vendore dhe fusha që lidhen me to. <i>RVB, Aneks Nr 42, Aneks Nr 6-Rregullore e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Për ngritjen dhe vazhdimësinë e programit janë konsultuar, universitete partnere dhe eksperiencat e shkollave Europiane dhe më gjerë duke mbajtur praktikat më të mira për këtë program, me dëshirën për të qëndruar gjithmonë koherentë me programet e studimit të cilat reflektojnë nevojat e këtij profesioni në sferën lokale dhe globale. Ky proces ndodh në formë periodike në përputhje me nevojat e programit dhe legjislationit në fuqi. <i>RVB, Aneks Nr 6</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Në rregulloren e programit përcaktohen qartë raportet mbi bazën teorike dhe praktike të formimit të studentit si dhe objektivat formuese të programit. Mënyra e organizimit dhe përfshirjes të të gjithë elementëve mësimore si dhe veprimtarive formuese midis formimit teorik dhe praktik në planin mësimor tregojnë se ky program ka arritur të përcjellë tek studentët formimin profesional të duhur duke i mundësuar atyre me sukses transferimin e studimeve kur ka qenë e nevojshme, mobilitetet</p>

	<p>në vende të ndryshme si dhe më e rëndësishmja punësimin e tyre në përfundim të studimeve.</p> <p><i>RVB, Aneks Nr 6</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabusi është subjekt përmirësimi vjetor nga pedagogu i lëndës duke konsideruar përditësimet e vazhdueshme në literaturë që kjo disiplinë kërkon.</p> <p>Ne procesin e rishikimit syllabusit merret në konsideratë zhvillimet më të fundit shkencore në fushën e planifikimit, teknikat e GIS, kërkesat me tregun e punës, rekomandime nga sektori i biznesit si dhe rekomandime nga rrjeti Alumni.</p> <p><i>RVB, Aneks Nr 29-Syllabuset e programit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të masterit profesional në planifikim e GIS ,garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi bashkëkohore praktike për punë të pavarur të nivelit të lartë, qoftë kjo pranë institucioneve publike, pranë studiove të konsulencës dhe sipërmarrjes private, pranë strukturave të specializuara profesionale joqeveritare-jofitimprurëse, apo edhe ato kërkimore-shkencore e akademike.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>U_POLIS në hartimin dhe ofrimin e të gjitha programeve të studimit udhëhiqet nga parimi i përshtatjes dhe përputhshmërisë së tyre me nevojat e tregut të punës. Programi i studimit nga kenveshtrimi përmbajtsor është mbështetur edhe nga studimi i tregut të punës për këtë profesion. Ky studim tregu kryhet duke përdorur metoda formale (pyetësorë) dhe konsultat me ekspertë, kryesisht nga komuniteti i biznesit por edhe të tjerë si, ekspertë të fushës dhe të arsimit të lartë dhe sidomos të studentëve të diplomuar nëpërmjet rrjetit ALUMNI. Rrjeti i shtrirë i partnerëve të U_POLIS brenda dhe jashtë vendit, antarësimi në Shoqatën e Shkollave Europiane të Planifikimit (AESOP), si dhe numri i lartë i kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkepunimi ka bërë që U_POLIS të jetë i mirë-informuar mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Në të njëjtën kohë departamenti kryen përditësime duke u konsultuar me institucione të rëndësishme në treg, që janë ofruesit më të rëndësishëm të vendeve të punës që lidhen me programin. Pjesë integrale janë edhe përvojat e studentëve që kanë ndjekur/ndjekin studimet në këtë program të cilët janë të punësuar në tregun e punës. Kombinimi i dijes me punën e pavarur të studentit nëpërmjet projekteve praktike, mundëson përgatitjen e tyre të mjaftueshme teorike e praktike duke maksimizuar mundësitë e tyre për punësim.</p> <p><i>RVB, shenimet e takimeve, lista e marrëveshjeve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Emërtimi, përmbajtja, objektivat, vizioni dhe standartet e përcaktuara për këtë program studimi janë në përputhje me aktet ligjore dhe</i></p>

	<i>nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmirësimi i programit mësimor dhe përputhshmëria e tij me kërkesat dhe tregun e punës është një domosdoshmëri. Përmirësimi periodik ndodh gjithmonë në bashkëpunimin me studime të vazhdueshme të tregut, ku përfshihen një sërë të dhënash të mbledhura kryesisht nga ZMSKK dhe ALUMNI. Paralelisht me rekomandimet nga aktoret e brendshme, një vendim dhe rendesishme i kushtohet përfshirjes në programin mësimor të arritjeve më të sukseshme nga universitetet partnere europiane në fushën e planifikimit. Për rishqyrtimin periodik dhe përmirësimin e kurikules mesimore funksionon procedura e ndjekur me marrjen dhe analizimin e “feed-back” të vazhduar nga studentët e diplomuar duke parë ecurinë dhe ndërmarrë korigjimet përkatëse dhe të nevojshme për propozimin e ndryshimeve të kurrikulës, nga anëtarët e departamentit përkatës, aprovimin e tyre në dekanat, dhe së fundmi miratimi i ndryshimeve në Senatit Akademik. <i>RVB, Aneks Nr.1 statuti, Aneks Nr 32, ASCAL tabela Nr24</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.	Studentët gjithashtu janë pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Përfaqësues të studentëve janë të pjesë e organeve më të larta drejtuese të U_POLIS, si Senatit Akademik, ashtu edhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë mënyrë ata janë pjesë e vendimarrjes dhe kanë mundësi të shprehin mendimin e tyre mbi përmbajtjen dhe mënyrën e zhvillimit të lëndëve/kurrikulës së programit. Kjo përfaqësi është shumë mirë e rregulluar nëpërmjet Senatit Studentor <i>RVB, Aneks Nr.1 statuti, Aneks Nr 32, ASCAL tabela Nr24</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e	Njësia përgjegjëse përmirëson dhe përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, dhe institucione publike e private. Sikunder verifikohet edhe nga dokumentacioni shoqerues i RVB bashkëpunimet me partnerë, rrjete dhe organizma të ndryshëm, të cilët kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë duke përditësuar universitetin me zhvillimet më të fundit të tregut. Bashkëpunimet me Shoqatën e Bashkive dhe me pushtetin lokal materializohen me kontribute sociale ose me ekspertiza që stafi

mjekësisë) dhe institucione publike e private.	dhe studentët e programit të studimit Master Profesional në “Planifikim Teritori dhe GIS”, japin për to apo për qeverinë qëndrore. <i>RVB, Aneks Nr.1 statuti, Aneks Nr 32, ASCAL tabela Nr5</i>						
Konkluzione	<i>Bashkëpunimet me partnere vendas e ndërkombetare kanë ndikuar pozitivisht në pasurimin e programit të studimit dhe përshtatjen e tij konform kërkesave të tregut të punës. .</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Rregullorja e Programit gjithashtu përcakton se objektivat dhe prioritetet e programit mësimor janë hartuar në përputhje me inovacionin në kërkim, ekselencën akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Këto synime garantojnë punësimin e studentëve të diplomuar si në sektorin publik edhe në atë privat. Po kështu mbështetur edhe në Strategjinë e Zhvillimit 2021-2026 të Universitetit POLIS, kapitulli 3, ka të bëjë pikërisht me përcaktimin e mënyrës së zhvillimit të kërkimit shkencor në universitet, sipas së cilit Universiteti POLIS, në ndjekje dhe zbatim të misionit të tij për të krijuar, zhvilluar, transmetuar dhe mbrojtur njohuritë teknologjinë dhe lidërsipin për zhvillim dhe inovacion, në pesë vitet e ardhshme parashikon të bëhet një institucion që gëzon reputacion ndërkombëtar për kërkimin inovativ gjithëpërfshirës dhe ndërdisiplinor i matur pas kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>RVB, Aneks Nr.2 strategjia e zhvillimit, Aneks Nr 6, Rregullore e programit</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Te gjitha objektivat kërkimore të programit janë në përputhje me prioritetet e programit të studimit në nivel departamentit dhe rrjedhojë e objektivave kërkimore e prioritare të institucionit.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Si pjesë e pandashme e programit të studimit, Workshop-et, puna në laboratorë dhe bashkëpunimet institucionale, janë disa nga format me të cilat ky program studimi përpiqet të përshtatet ndaj trendeve të zhvillimit lokal apo ndryshimeve me impakt botëror. Studentëve u ofrohet mundësia e

	përdorimit të ambienteve laboratorike në mjediset universitare. U_POLIS ka një sërë laboratorësh të ndryshëm prej të cilëve katër përdoren nga programi Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS”. Laboratori i GIS-it, i lejon studentët nëpërmjet hardware-ve të eksplorojnë dhe zhvillojnë më tej njohuri në lidhje me sistemet gjeografike të informacioni, programeve si ArcMap online apo Qgis të cilat janë tashmë pjesë e pandashme e punës së planifikuesit urban, eksperteve të menaxhimit të të dhënave apo studiuesve mjedisorë.						
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Në nivel departamenti, çdo vit hartohet plani vjetor i kërkimit shkencor, i cili miratohet në nivel dekanati. Pjesë përbërëse e këtij plani është edhe plani i shpenzimeve, që parashikon mbështetjen financiare të formave të ndryshme të kërkimit shkencor si pjesëmarrje në konferenca, workshop-e, publikime librash apo artikujsh etj. <i>RVB, Aneks 26 Procedura e mbështetjes financiare për stafin akademik)</i>						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka gjithë kapacitetin njerëzor, financiar, infrastrukturor për të kryer një kërkim shkencor dhe punon në vazhdimësi për bashkëpunime në projekte të cilat nxisin kërkimin dhe innovacionin.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Në vijim të kësaj edhe programi Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS” i kushton vëmendje të veçantë mënyrës së organizimit dhe ofrimit të kurrikulës ndarjen e qartë midis teorisë dhe praktikës, punës me projektet çka kërkon krijimin e punës në grup jo vetëm nga ana e studentëve por dhe e stafit të angazhuar në këtë program. Lëndët dhe modulet e programit janë të organizuara ndërmjet teorisë dhe praktikës, mësimit të bazuar në projekte dhe punës laboratorike. Shumë nga projektet e kërkimit shkencor propozohen nga anëtarët e stafit në fushat e tyre të interesit. Liria akademike dhe objektivi dhe prioritetet kërkimore të njësisë duket se janë në përputhje të plotë me prioritetet kërkimore të UPOLIS. Nga ana tjetër liria akademike është pjesë thelbësore e Statutit të U_POLIS dhe Rregulloren e Përgjithshme, ndërkohë që Fakulteti bashkërendon më



	<p>së miri mësimdhënien, kërkimin shkencor por dhe aspektin kulturor dhe social Departamenti kujdeset për stafin akademik, për ngarkesën e tyre në mësimdhënie si dhe në punët administrative të IAL. Shkalla e lirisë akademike të stafit të U_POLIS është e pa cenuar, ata mund të zhvillojnë kërkime shkencore në mënyrë të pa penguar dhe mund të kërkojnë edhe ndihmën institucionale që në fakt edhe ju ofrohet.</p> <p><i>RVB; Aneks Nr.45; Aneksi Nr.32; tabela ASCAL Nr5 Aneksi Nr.7</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit MP ne Plaifikim Territori dhe GIS përkatësisht kurrikula me lëndët e sajë dhe syllabuset e tyre qartësojnë prioritetet dhe objektivat e studimit. Ato janë me përmbajtje të thelluar shkencore, që si produkt i programit të studimit do të krijohen profesionist të cilëve ju jepet mundësia për vazhdim të studimeve të mëtejme në ciklin e tretë si dhe mundësi e zhvillimit të veprimtarive profesionale në tregun e punës. Në shumë projekte të Universitetit vlerësohet se pjesëmarrja e studentëve ka qenë thelbësore. Organizimi i workshopeve, puna në Laboratore brenda IAL si dhe bashkëpunimet institucionale ndihmojnë studentët në këtë program të studimit, ndërsa brenda programit të studimit, kurrikula përmban lëndën e workshopeve.</p> <p><i>RVB; Aneks Nr.45; Aneksi Nr.32; tabela ASCAL Nr5 Aneksi Nr.7</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave me karakter kërkimor aplikative dhe nxit studentet për realizimin e këtyre objektivave .</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Universiteti realizon studime të vazhdueshme të tregut të punës, rezultatet e të cilave synohet të ndikojnë në përmirësime apo ndryshime të programit mësimor dhe përputhshmëria e tij me tregun e punës. Vihet re një bashkëpunim në rritje me Agjenci lokale dhe kombëtare, por jo rrallë dhe ndërkombëtare. Krahas bashkëpunimit në aktivitete të ndryshme, shpesh rezultat i këtij bashkëpunimi janë dhe ndërhyrjet në programin mësimor, pas një sërë konsultimesh mes aktorëve.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet</p>	<p>N/A</p>

ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).							
Konkluzione	<i>GVJ gjatë takimit me stafin akademik konstatoj se shkalla e lirisë të nivelit akademik është e pa cenuar dhe se IAL i motivon që ata të jenë edhe më shumë të angazhuar për fushat e kërkimeve, ndërsa asnjë ndërhyrje në proceset e mësimdhënies nuk është identifikuar. IAL ka rregulloret e brendshme Institucionale dhe statutin të cilat sigurojnë shkallën e lirisë akademike të stafit. Nga takimet e GVJ me ZMSKK është konstatuar se kjo zyre jep kontribut lidhur me ndryshimin e kurrikules në bashkëpunim me Alumni duke provuar feedbackun nga studentet e diplomuar,</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i RVB, por dhe nga vizita në Universitetin POLIS, u konfirmua se përveç formave standarde të mësimdhënies, mësimnxënies si leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike u konstatuan dhe një sërë forma të veçanta të përdorura nga institucioni si: <ul style="list-style-type: none"> • Puna në grup me student të programeve të ndryshme • Prezantimet / ekspozimet publike • Vizita në terren Kjo e fundit karakteristike për institucionin pasi në këtë mënyrë studentëve u jepej mundësi për të pasur kontakt me realitetin dhe problematikat në lidhje me planifikimin dhe shqetësimet e qytetit. <i>RVB; Shenimet nga takimet</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e	Personeli akademik vepron krejtësisht i lirë në përcaktimin e metodologjive të mësimdhënies, duke u koordinuar me departamentin mbi cilësinë dhe vazhdimësinë e mësimdhënies dhe më pas me dekanatin mbi rolin dhe hapësirën në programin e

mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	studimit. Ky zinxhir koordinimi është i nevojshëm për të adresuar raportin e metodikave në mësimdhënies, balanca midis lëndëve dhe module por dhe koordinimi me objektivat e mësimdhënies dhe cilësisë së ofrim të programit. NJSBC pjesë e U_POLIS, është monitoruese dhe indikator për rritjen e cilësisë akademike e cila zyre punon sipas rregullores institucionale të miratuar. Brenda institucionit bëhen vlerësime të mësimdhënësve nga studentët dhe në varësi të rezultateve IAL reagon. Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti i Planifikim dhe Menaxhim Urban. <i>RVB; Shenimet nga takimet</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Pjesëmarrja dhe angazhimi i personelit akademik në shume projekte kerkimore si dhe trejnuese me insitucione e partnere nderkombetare eshte nje garanci me tej per permiresimin e kompetencave didaktike dhe perfshirjen ne mesimdhenie te metodologjive te reja e bashkekohore. <i>RVB; Shenimet nga takimet, lista e projekteve</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në program ka eksperiencë profesionale dhe mbështetje të plotë nga njësia bazë dhe ajo kryesore për përmirësimin dhe zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një-drejtimore (nga pedagogu tek studenti), këto metoda orijtojnë drejt formave të mësimin me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e lektorit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve. Në këtë aspekt lënda është subjekt i vazhdueshëm përmirësimi të cilësisë, forma e mësimdhënies përcaktohet nga pedagogu, koordinohet nga departamenti dhe miratohet nga dekani.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një-drejtimore (nga pedagogu tek studenti), këto metoda orijtojnë drejt formave të mësimin me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu në klasë eshte edhe lektor por edhe moderator e lehtësues i kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve. <i>RVB; Shenimet nga takimet</i>

<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>NJSBC pjesë e U_POLIS, është njesia përgjegjëse monitoruese dhe indikator për rritjen e cilësisë akademike. Brenda institucionit bëhen vlerësime të mësimdhënësve nga studentët dhe në varësi të rezultateve IAL reagon. Krahas prezantimit të rezultateve të vlerësimit rëndësi ju jepet dhe komenteve të bëra nga studentet dhe stafi (peer review) duke theksuar përvojat e mira dhe duke nxitur diskutimet dhe shtrirjen e tyre në të gjithë institucionin. Gjithashtu nepermjet projekteve të shumta nderkombetare me focus ngritje kapacitetesh, departamenti dhe UPOLIS mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në takimet e GVJ me studentët dhe me mësimdhënësit vlerësuam se pjesa dërmuese e Studentëve bën vlerësimin e lëndës dhe mësimdhënësit sipas kriterëve të përcaktuara nga Institucioni. Këto vlerësime janë autonome dhe të paanshme. Ato kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarive akademike..</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Të gjitha rregullat dhe format e vlerësimit të studentëve përcaktohen në Rregulloren Didaktike, e cila është e publikuar në sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave nga studentët. Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare. Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i qasen në çdo moment. <i>RVB; Aneks Nr.3-Rregullore e pergjithshme, Aneks 4-Rregullore Didaktike</i></p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloret e U_POLIS dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lende me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/ modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton te jete realizuar një proces i tille. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës. <i>RVB, Aneksi Nr.29 Syllabuset e programeve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas Rregullores se provimeve, testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj.), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse për mbrojtjen e diplomës. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zberthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është e qëndrueshme dhe e vazhdueshme gjatë zhvillimit të mësimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë takimeve të GVJ me studentët e programit të studimeve Master profesional në Plaifikim Terriori dhe GIS u konstatua se studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të mësimi. Universiteti POLIS vlerësohet se realizon testim të njohurive të studentit gjatë gjithë vitit. Kjo është përcaktuar dhe në Rregulloren Didaktike të cilën kemi marrë në shqyrtim dhe që është dokumenti rregullator bazë që garanton vlerësimin e drejtë dhe transparent bazuar në meritën e çdo student. Pikërisht kësaj rregulloreje i referohet dhe stafi akademik i Universitetit, ndërsa rezultatet e çdo vlerësimi bëhen publike nëpërmjet sistemin Pitagora. Hedhja e çdo vlerësimi bëhet nga pedagogu në sistem dhe studentët</p>

	marrin vlerësimin në kohë reale. Një procedurë e tillë zbatohet dhe për vlerësimin përfundimtar.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	IAL ndër vite ka operuar me platforma të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, ndërsa vihet re se ky sistem është konsoliduar më shumë gjatë periudhës së pandemisë. Më konkretisht në platformën Google Class Room është krijuar një hapësirë e posaçme për të hedhur vlerësimin, mungesat dhe angazhimin e studentit pas çdo seance mësimore. Vihet re se platforma e mësipërme është shtesë e sistemit të vlerësimit dhe testimit elektronik, që në fakt zbatohet në këtë Universitet që nga vitit 2006. U_POLIS ka një sistem elektronik të ruajtjes së shënimeve të studentëve i cili është i qëndrueshëm dhe shumë funksional, ndërsa ju shërben studentëve dhe mësimit dhe G store – Google Classroom si dhe platforma Pitagora e cila ju mundëson studentëve përmes qasjes të shohin informatat lidhur me vlerësimet e tyre, lëndët dhe informatat në kohë reale nga IAL. https://polis.pitagora.rash.al/login
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësim përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me komponentet e parashikuar në syllabusin e lëndës I cili është miratuar nga përgjegjësi i departamentit siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithshme e IAL-së dhe rregulloret e FPMU.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Universiteti ka ndertuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar një mënyrë transparente vlerësimin e dijeve. I kushtohet shumë rëndësi ruajtjes së të dhënave të studentit dhe konfidencialitetit. Studenti posedon kredencialet e tij me të cilat vetëm ai ka qasje në hapësirën e tij të dedikuar. Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Gjatë gjithë periudhës studentit i jepet mbështetje, këshilla për t'u përmirësuar në të ardhmen, gjë që ndikon më pas dhe në vlerësimin final. Vlerësimi final merret nga studentin në kohë reale nëpërmjet sistemit, ajo që u vërejt është që vlerësimi i vazhduar dhe në veçanti komunikimi mes stafit dhe studentëve është mjaft i shëndetshëm. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e provimeve sallat e leksioneve, që janë të pajisura me kamera, për monitorimin e procesit të provimit. <i>RVB, Shënime në vizitë; Aneksi Nr. 4;</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose

	<p>gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Një gjë e rëndësishme që mund të evidentohet është moslejimi në mënyrë kategorike i kopjimit në detyra apo provime. Njëzëri stafi akademik është kategorik dhe i prerë në raste të tilla. Nëse kjo ndodh studenti jo vetëm përjashtohet nga provimi, por rasti i kalon Këshillit të Etikës. Ndërkohë detyrat, projektet e ndryshme, artikujt para vlerësimit i nënshtrohen dhe kontrollit në sistemin e plagjiaturës Turnitin.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem notash kaluese nga 10 deri në 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi Pitagora, ose edhe me komunikim verbal dhe individual. GVJ konstaton se vlerësimi i studentëve publikohet në mënyrë të detajuar, duke përfshirë në tabelë të gjithë komponentët e vlerësimit, ndërsa koha e dhënies së vlerësimit është tre ditë pas dhënies së provimit. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet teste me pyetje alternative, projekteve e prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p><i>RVB, sistemi i platformës Pitagora</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vlerësimit, vihet re se respektohet plotësisht e drejta e studentëve për të kontestuar vlerësimin e marrë. Ka një procedurë të mirë përcaktuar në raste të tilla dhe më konkretisht studenti dorëzon pranë Sekretarisë mësimore kërkesën zyrtare. Sekretaria njofton Dekanatin përgjegjës, dhe në rastet kur kërkesa pranohet bëhet ngritja e Komisionit të Vlerësimit i cili shqyrton ankesat e studentëve. Në rast të ndryshimit të vlerësimit hartohet procesverbali përkatës dhe për këtë rezultat të ri ose jo njoftohet Sekretaria Mësimore dhe studentët e përfshirë në ri-vlerësim. I gjithë dokumentacioni pjesë e këtij procesi ruhet në Sekretarinë mësimore. Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë.</p> <p><i>RVB, Aneksi Nr. 4.</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ, Universiteti POLIS na vuri në dispozicion të gjithë dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet e tyre apo rishqyrtime të vlerësimit. Procedura është transparente për të gjithë palët e përfshira në proces dhe e arkivuar. Kërkesa për ankimim note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në U_POLIS.</p> <p><i>RVB, Shenimet nga takimet</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se vlerësimi i studentëve publikohet në mënyrë të detajuar, duke përfshirë në tabelë të gjithë komponentët e vlerësimit, ndërsa koha e dhënies së vlerësimit është tre ditë pas dhënies së provimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike shkencore ne fushën e planifikimit, praktiken profesionale dhe diplomën. Syllabuset e lëndës paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Staf i akademik përfshin studentet në veprimtari jashtëkurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e planifikimit dhe përdorimit të teknikave të GIS. Studentet përfshihen edhe në veprimtarinë kërkimore aplikative të stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi. <i>RVB, Aneks Nr.2.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ne raportin e hartuar nga GVB, por dhe nga vizita në institucion u konstatua se departamenti i ofronte studenteve informacion të detajuar mbi Sistemet Gjeografike të informacionit që lidhen me profesionin e planifikimit. Punimi i detyrave dhe projekteve gjatë për kohën e sotshme është e pamundur të realizohen pa përdorimin e softwer-ve profesional prandaj edhe FPMU dhe DPMU janë shumë të vetëdijshëm për këtë çështje, prandaj progresi i studentëve është në kohë reale.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Vlerësimi i njohurive të fituara në çdo lëndë kryhej në disa nivele, nëpërmjet vlerësimit të pedagogut dhe performancës së mësimdhënies, më pas studenti në përputhje me termat e referencës së detyrës përfundimtare, provimit, punimit në grup etj., përfiton një vlerësim pikësorë të bazuar në syllabusin e lëndës mbi performancën e tij në komponentët e vlerësimit të cilët i bëhen të ditur studentit në fillim të lëndës. Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur në syllabus. Këto elemente që detajohen në çdo lende janë pjesë e objektivave të përgjithshme të programit. <i>RVB, Aneks Nr.29 Syllabuset e programeve.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u	Gjatë vizitës u vu re se universiteti disponon laboratorë me infrastrukturë bashkëkohore çka i jep mundësi studentëve të zhvilloj

<p>japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale në lidhje me këtë program të studimit. Studentët e programit master professional në Plaifikim Territori dhe GIS kanë në dispozicion laboratorë të ndryshëm si dhe mundësinë e zhvillimit të praktikës profesionale. Përsa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e vet me strukturat e tjera, duke i asistuar në zhvillimin e praktikave profesionale, kryesisht studentet që nuk janë në marrëdhënie pune. Puna në grupe ishte një tjetër mënyrë ndërveprimi i procesit të mësimdhënies, çka i parapërgatit studentët për tregun e punës. GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës. Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përbën një ndër kompetencat e këtij programi mesimor. <i>RVB, Takimi i GVJ me mësimdhënësit në ambientet e Laboratoreve</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik të programit të studimit kanë qene ose janë pjesë e programit të doktoratës, çka kanë pasur mundësi të njihen me metodologji të reja të mësimdhënies, forma të reja bashkëkohore të cilat i përdorin dhe i përcillnin me sukses edhe tek studenti. GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në IAL janë funksionale qendrat kërkimore.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuar kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nëpërmjet strukturës së Innovation Factory dhe laboratorit të ri të fabrikimit dixhital studentët me ide më inovative mbështeteshin për të avancuar idetë e tyre dhe për prototipizuar ato. GVJ gjatë vizitës fizikisht në laboratorë konstatoi që disa prej modeleve 3D të krijuara nga Studentët aplikojnë teknologjitë e reja bashkëkohore. U_POLIS jo vetëm krijon këto mundësi për studentet e të gjitha programeve që ai ofron por nëpërmjet një gamë të zgjeruar marrëveshjesh institucionale me universitete të tjera publike e private ofron këto laboratore për mundësi të shfrytëzimit të tyre për interesa të përgjithshme.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në IAL janë funksionale qendrat kërkimore.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		
	plotësisht	kryesisht	plotësisht
			X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar por dhe nga vizita në institucion u vërtetua se Universiteti POLIS, disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore të Përgjithshme • Rregullore Programi (për çdo program) • Rregullore Diplomimi (për çdo program) <p>Keto rregullore bëjnë të mundur parashikimin e të gjitha procedurave në formë të detajuar, mënyrën se si studenti, ndjek programin por dhe e përfundon atë. Rregullorja e programit Master Profesional në nenin 11, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i ngritjes së komisionit për diplomim. Disa nga procedurat për provimin përfundimtar të diplomës janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me miratim të dekanatit ngrihet grupi i punës për mbarëvajtjen dhe monitorimin korrekt të procedurave të provimit final. • Grupi i punës ndërton listën e plotë të pyetjeve që përfshijnë tematikat e zhvilluara gjatë programit Master Profesional. • Lista me literaturën e plotë vendoset në dispozicion të studentit në version e printuar pranë bibliotekës së Universitetit si edhe në versionin elektronik, adresa e të cilës u njoftohet paraprakisht studentëve të masterit profesional. • Teza konceptohet me këtë përmbajtje: 40% (dyzet për qind) e vlerësimit i takon pyetjeve të specialitetit, dhe 60% (gjashtëdhjetë për qind) pyetjeve nga tematikat e tjera të zhvilluara gjatë programit master profesional. • Komisioni i ngritur për hartimin e tezave, do të kryejë dhe procedurën e korrigjimit të përgjigjeve të tyre, brenda 1 (një) jave nga data e provimit do të dale me një vlerësim paraprak sipas pikëve të tezës së provimit. • Studentët do të njoftohen për vlerësimin paraprak duke ju dhënë mundësia të shprehin me shkrim komentet / ankesat e tyre lidhur me vlerësimin paraprak. Pasi të shqyrtohen edhe komentet e studentëve, komisioni shpall rezultatet finale të provimit që janë të parevokueshme.

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. Lista me literaturën e plotë vendoset në dispozicion të studentit në version e printuar pranë bibliotekës së Universitetit si edhe në versionin elektronik, adresa e të cilës u njoftohet paraprakisht studentëve të masterit profesional.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i miratuar nga dekanati pergatit tezen e provimit perfundimtar e cila konceptohet me këtë përmbajtje: 40% (dyzet për qind) e vlerësimit i takon pyetjeve të specialitetit dhe 60% (gjashtëdhjetë për qind) pyetjeve nga tematikat e tjera të zhvilluara gjatë programit master profesional. Gjithashtu pjesë e rëndësishme e tezës janë edhe rregullat e detyrueshme për mbarëvajtjen e procesit të provimit, përfshirë këtu edhe kohëzgjatjen e provimit. Teza hartohet në gjuhën shqipe dhe anglisht. Po komisioni është edhe përgjegjës të kryejë edhe procedurën e korrigjimit të përgjigjeve të tyre, brenda 1 (një) jave nga data e provimit do të dale me një vlerësim paraprak sipas pikëve të tezës së provimit. Studentët do të njoftohen për vlerësimin paraprak duke ju dhënë mundësi të shprehin me shkrim komentet / ankesat e tyre lidhur me vlerësimin paraprak. Pasi të shqyrtohen edhe komentet e studentëve, komisioni shpall rezultatet finale të provimit që janë të parevokueshme.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Për t'u përgatitur për provimin studentët zhvillojnë një takim paraprak me koordinatorët e programit, ku informohen mbi kushtet dhe kërkesat e procesit, i jepet akses në arkivën e studentit, ku gjendet informacioni për të gjitha lëndët e zhvilluara përgjatë këtij masteri, i cili është i ndarë në: literaturë të detyrueshme, literature të sugjeruar, leksione dhe një përmbledhje teorike dhe praktikë për lëndën. Në vazhdimësi studentët kryejnë dy seanca përsëritëse me pjestarët e komisionin ku diskutohen konceptet më të rëndësishme teorike të përfituara në çdo modul dhe një seri ushtrimesh llogjike.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin mesimor të Masterit profesional në planifikim e GIS, asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve për të gjitha detyrat që ata kanë gjatë procesit mesimor duke vënë në dispozicion mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Teza përfundimtare përmban 6 ECTS dhe vlerësimi i saj bëhet nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e provimeve përfundimtare. Procedurat dhe afatet janë të parashikuara në kreun e parë të rregullores së diplomimit miratuar nga dekanati në 2021-2022. Të gjithë pjestarët e komisionit për shqyrtimin e vlerësimit kanë gradën "Doktor", kjo është e përfaqësuar edhe në programin mesimor të</p>



	<p>programit Master Profesional. Tezat e diplomës hartohen nën kujdesin e komisionit, koordinatorit të programit dhe propozimeve të profesorëve të përfshirë në këtë program studimi. Procesi i përgatitjes për provimit përfundimtar të diplomës udhëhiqet nga komisioni i diplomave, koordinatori i programit dhe aprovohet nga dekani i fakultetit. I njëjti komision është edhe përgjegjës për korrigjimin e tezave brenda 1 (një) jave nga data e provimit do të dalë me një vlerësim paraprak sipas pikëve të tezës së provimit. Studentët do të njoftohen për vlerësimin paraprak duke ju dhënë mundësia të shprehin me shkrim komentet / ankesat e tyre lidhur me vlerësimin paraprak. Pasi të shqyrtohen edhe komentet e studentëve, komisioni shpall rezultatet finale të provimit që janë të përvokueshme.</p>						
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Diploma “Master Profesional” fitohet kur studenti kryen me sukses mbrojtjen finale të provimit përfundimtar, që kryhet para një komisioni të prej të paktën 3 (tre) pedagogësh nga stafi i programit Master Profesional, pasi studenti ka përmbyllur detyrimet e planifikuara dhe ka paraqitur kërkesën me materialin final për mbrojtje. Diplomimi i studentit shoqërohet me diplomën ku shfaqet numri i matrikulit të studentit; suplementi i diplomës ku ilustrohen lëndët; modulet në vite dhe vërtetime për kreditet ECTS; katalogu i lëndëve të zhvilluara në vite me përshkrimin dhe peshën në kredite të çdo lënde.</p>						
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>POLIS ka një arkivë elektronike dhe fizike e cila ruan informacionin e plotë për studentin. Ky informacion depozitohet në arkivën qendrore pas diplomimit të studentit. Vlerësimi për të gjitha lëndët, orët, kreditet dhe notën përfundimtare të lëndës, regjistrohen në regjistrin e arritjeve nga sekretaria mësimore dhe ruhen në institucion për një afat të pacaktuar.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e asiston atë në përgatitje si dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbylljes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbylljet pjesërisht</th> <th>Përmbylljet kryesisht</th> <th>Përmbylljet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbylljet pjesërisht	Përmbylljet kryesisht	Përmbylljet plotësisht			X
Përmbylljet pjesërisht	Përmbylljet kryesisht	Përmbylljet plotësisht					
		X					

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë

U_POLIS ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të realizuar kërkesat e nevojshme të studentëve për ngritjen e kapaciteteve praktike, nëpërmjet punës në laboratore dhe bashkëpunimit të

<p>institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>vazhdueshëm me institucione dhe agjenci për zhvillimin e praktikave mësimore. U_POLIS ka një numër të konsiderueshëm laboratorësh të posaçme për realizmin e praktikës në këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i Efijencës së Energjisë • Laboratori i Qëndrueshmërisë • Laboratori i Mjedisit • Laboratori CAD dhe GIS LAB <p>Partnerët e U_POLIS që përfshijnë organizata nga sektori publik dhe privat, që variojnë nga organe qeveritare (ministri, bashki); institucione të Arsimit të Lartë; kompani privat, nëpërmjet të cilave studentët kanë mundësi plotësimin e gamës së njohurive të tyre profesionale për programin përkatës. Praktikantët profesionale përcel kompanive apo institucione ku punojnë vet studentet mund zhvillohen edhe pranë kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, proces ky që menaxhohet me efektivitetin më të madh.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Në rast se studentët zgjedhin të zhvillojnë praktikën pranë ndonjë institucioni tjetër, atëherë departamenti në bashkëpunim me zyrën për mbështetje dhe këshillim karriere merr informacionin paraprak dhe më pas vlerëson nëse praktika mund të zhvillohet apo jo pranë këtij institucioni. E gjitha kjo bëhet për të siguruar një praktikë sa më efektive dhe në përputhje me objektivat e vetë programit të studimit. Për më tepër, Njësia e Projekteve si një njësi e pavarur bashkëpunon me të gjithë departamentet dhe zyrat për të asimiluar informacionin dhe për të rritur rrjetin e partneriteteve që ky universitet ka në përpjekje për të përmbushur objektivat institucionale. Shkëmbimet institucionale të stafit akademik dhe studentëve ndodhin në vazhdimësi të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e cila vepron në përputhje me rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë akademike, kërkimore, kulturore dhe administrative të universitetit, ka si qëllim të vlerësojë performancën e komponentëve në cilësinë e përmirësimit dhe rritjes institucionale.</p>
<p>Kriteri 3. Praktikantët profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Në rastet kur studentët nuk kanë një marrëdhënie pune ku mund të zhvillojnë praktikën, U_POLIS angazhohet për të garantuar praktikantët mesimorë në institucionet lokale që ajo ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto marrëveshje kanë qenë të përhershme ose të përkohëshme në varësi të kërkesave. Si praktika të mira mund të përmendim bashkëpunimet me: AKPT, GIZ, Co-plan, REMAX, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Bashkia Tirane, Drejtorinë e Hekurudhës Shqiptare, etj. Gjithashtu në përgjigje të studentëve zyra e këshillimit të karrierës ndan në mënyrë periodike informacione mbi mundësi intershipi, mundësi punësimi apo bashkëpunime specifike në bazë projektsh. Aktiviteti profesional i zhvilluar nga studentët gjatë procesit akademik dokumentohet dhe transferohet në</p>


	kredite dhe dokumente të posaçme sipas standardeve të sistemit ECTS. Mendimi i trajnerëve konsiderohet shumë e rëndësishëm jo vetëm për zbatimin e mëtejshëm të programit didaktik, por edhe për të kuptuar nivelin e përgatitjeve që marrin studentët në lidhje me jetën e përditshme profesionale.			
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e më sipërme në përgjigje të kritereve të këtij standardi GVJ, konkudon se ky program studimi ndjk procedura të qarta për realizimin e praktikës profesionale e mësimore, si edhe institucioni asiston studentët në kryerjen me sukses të këtyre praktikave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Gjatë vizites në U_POLIS, GVJ u interesua për të dhënat lidhur me personelin akademik PAE, PAK dhe me atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. GVJ konsultoi dokumentin e sjellë nga Institucioni lidhur me plotësimin e këtij kriteri si dhe protokollin e mbajtur gjatë vizitës në IAL dhe konkludon në plotësimin e këtij kriteri nga ana e institucionit. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore na u vunë në dispozicion dosjet personale për secilin staf akademik te angazhuar, te cilat përmbanin CV-të, diplomat dhe kualifikimet e stafit, kontraten e punes dhe deklaratën individuale te ngarkeses akademike dhe kerkimore, etj. Krahas këtij dokumentacioni fizik dhe me sa u shpjegua nga zyra, secili antar i personelit akademik ka dhe profilin e tij në sistemin elektronik të menaxhimit të IALsë. <i>RVB, Aneks Nr 47, Strategjia e Burimeve Njerezore, Aneks Nr 50 Formular vleresimi per rekrutim stafi, Aneks Nr.14-Guida e stafit</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit	Nga RVB, GVJ mësoi që nevojat për rekrutim personeli i paraqet Departamenti që mbulon programin e studimit. Nevojat mbështeten në shpërndarjen sa më racionale të ngarkesës mësimore të lëndëve të

<p>në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>kurrikulës konkrete. Pra personeli i rekrutuar lidhet konkretisht me përballimin sa më të plotë të ngarkesës së lëndëve për të cilat ka edhe përvojën edhe njohuritë e duhura që garantojnë zhvillimin me cilësi të procesit mësimor dhe angazhim në punën kërkimore shkencore. Fakulteti gjithashtu, disponon ngarkesën e stafit për secilin semestër (orët totale), angazhimin e tij në lëndët përkatëse, si edhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Koordinatorin e programit në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Gjatë takimeve në institucion GJV mësoi që personat e rekrutuar kanë përballuar me cilësi ngarkesën mësimore dhe kanë angazhim domethënës në kërkimin shkencor. Në takimin me studentët, ata shprehën vlerësime për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët e angazhuar në programin e studimit Master Profesional ne Planifikim Territori e GIS.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore te UPOLIS disponon databazën e plotë për të gjithë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, sëbashku me dokumentacionet e nevojshme ligjore për gjithësecilin. Fakulteti gjithashtu, disponon ngarkesën e stafit për secilin semestër (orët totale), angazhimin e tij në lëndët përkatëse, si edhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Koordinatorin e programit në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. <i>Aneks Nr 50 Formular vleresimi per rekrutim stafi, Aneks Nr.14-Guida e stafit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>U_POLIS ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik synim i së cilës është tërheqja e stafit kryesisht të huaj të kualifikuar me grada e tituj shkencor, dhe me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Aktualisht U_POLIS plotësimin e nevojave për staf të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë ka arritur të realizojë duke punësuar profesionistë vendas dhe të huaj me përvojë në fushën akademike. Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me personel të brendshëm e të qëndrueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>U_POLIS, ka personel ndihmës akademik, të angazhuar në manaxhimin dhe mirëpërdorimin e ambienteve laboratorike të ndodhura brenda mjediseve universitare. U_POLIS ka shtatë laboratorë prej të cilëve katër përdoren nga programi Master Profesional në “Planifikim Territori dhe GIS”. Përdorimi i tyre sipas programeve të ndryshëm mësimore apo moduleve të lëndëve të ndryshme, realizohet nga një ekip ndihmës eficient dhe profesional i cili është edhe përgjegjës, por gjithashtu orientues, motivues dhe mbështetës për punët laboratorike të studentëve. Këto laboratorë janë në dispozicion të plotë të studentëve dhe stafit akademik.</p>



<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>U_POLIS për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjeshme, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuara si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Zyra e Burimeve Njerëzore disponon databazën e plotë për të gjithë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, së bashku me dokumentacionet e nevojshme ligjore për gjithësecilin</p> <p><i>Aneks Nr.14-Guida e stafit</i></p>		
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Polis nxit bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis pjestarëve të stafit si në nivel institucional edhe në atë ndërinstitucional. Kjo është një veprimtari e vazhdueshme në kuadër të projekteve të përbashkëta, si: pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare; lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës. Partnerët dhe llojet e bashkëpunimit variojnë nga partneritetet afatgjata strategjike, me të cilët U_POLIS ofron programe akademike të përbashkëta si edhe në projekte kërkimore të përbashkëta, në partnerë <i>ad hoc</i> të përzgjedhur për veprimtari të caktuara si: workshop-et e përbashkëta; veprimtaritë kërkimore të përbashkëta; skema për mobilizim të personelit dhe studentëve etj.</p>		
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktika profesionale për studentët e U_Polis është komponent thelbësor për një formim të balancuar. Ky aftësim profesional ndodh si praktikë profesionale, ku studentët në bashkëpunim me departamentin shprehin dëshirën për të kryer praktikën mësimore në kompani ose studio, institucione publike apo private të cilat operojnë në fushën e arkitekturës dhe dizajnit urban. Ky proces i jep programit aftësitë profesionale dhe praktike për të bërë një lidhje të koncepteve dhe teorike në situatë reale dhe eksperiencë të lidhura me kontekstin shqiptar, përfshirja e studentëve në projekte me karakter projektimi të cilat janë mundësi unike për të zhvilluar aftësitë e tyre.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë takimeve në institucion GVJ mësoi që personat e rekrutuar kanë përballuar me cilësi ngarkesën mësimore dhe kanë angazhim domethënës në kërkimin shkencor. Në takimin me studentët, ata shprehën vlerësime për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogët e angazhuar në programin e studimit Master Profesional ne planifikim territori e GIS.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Në terma të infrastrukturës së nevojshme për realizimin e programit të studimit, POLIS disponon jo vetëm sipërfaqet e nevojshme në kuptimin e metrave katrore por dhe teknologji bashkëkohore për organizmin e mësimdhënies, praktikave dhe punëve laboratorike. Ambientet e vëna në dispozicion shfrytëzohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Auditorë mësimi , - Studio - Ambiente për aktivitete promovuese, - Laboratorë - Ambiente për kërkimin shkencor; - Ambiente shërbimi si (bibliotekë, salla interneti, fotokopjime, salla studimi, zyra për informim të studentëve - si dhe ambiente ndihmëse të tilla si korridoret, ballkonet banjot) <p>Numri i studenteve në këtë program studimi nuk është shumë i lartë duke e bërë shumë komod organizmin e punës në grupe dhe detyrave të kursit.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, i vizitoi të gjitha këto ambiente dhe konstatoi që ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke marrë në konsideratë numrin e studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit e moduleve përkatëse.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave Aneksi Nr.39-Lista e projekteve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme por dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studimi dhe punë të pavarur të studentëve. GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve të cilat përdoren për studentët. Të gjitha sallat e mësimi janë të pajisura me kompjuterë dhe projektorë, kurse laboratorët (ato të kompjuterëve) por dhe laboratorët e tjerë janë të pajisur me teknologjitë e nevojshme hardware dhe software për edukimin e studenteve.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të</p>	<p>Pjesë e dokumentacionit të RVB ishte dhe një listë e plotë e ambienteve mësimore perfshi këtu dhe laboratorë si: - Lab i Mjedisit - Lab i Eficences Energjitike (HVAC) - Dhe Lab i fundit i prototipizimit dhe fabrikimit dixhital. Të gjithë këto laboratorë përmbajnë pajisje të avancuara të cilat mundësojnë aftësimin praktik të studenteve. Gjatë</p>

<p>moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>vizitës në U_POLIS GVJ vizitoi mjediset mësimore ku zhvillohej procesi për realizimin e Programit të studimit në Master Profesional ne Planifikim e GIS të tilla si: auditorët, laboratorët, studiot, ambientet e shërbimit etj. dhe konstaton që ato janë të pajisura me mjete të tilla si kompjuterë, software profesionale, qasje në literaturë, mundësi shumëfishimi etj. të cilat garantojnë realizimin e procesit mesimor e praktik permes metodologjive bashkekohore.</p> <p><i>RVB: Shënimet e vizitave Aneksi Nr.39-Lista e projekteve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>U_POLIS aktualisht ka 8 laboratorë me sipërfaqe dhe kapacitete të ndryshëm, të gjithë të pajisur me kompjuterë dhe software të posaçëm për këtë program studimi si CAD, GIS, etj. në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA • Laboratori i MAC • Laboratori i Qeramikës • Laboratori i Pikturës/Ilustrimit • Laboratori i Prototipizimit – i pasuruar me shume pajisje te reja. • Laboratori i Fotografisë • Laboratori i Eficiences Energjetike • Laboratori i ri kompjuterësh për lëndë – digjital Architecture. <p>nje pjese e ketyre laboratoreve janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit Master Profesional në Plaifikim Terriori dhe GIS</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Krahas laboratorëve të vet, U_POLIS garanton realizimin e praktikave të ndryshme lëndore dhe profesionale në bashkëpunim me institucione të tjera që disponojnë pajisje specifike, si p.sh. laboratori ALTEA, instituti IGJEUM, etj.</p> <p>GVJ, mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion konstaton që IAL, kryesisht me kapacitetet që zotëron (laboratorë, studio) por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera (kryerjen e praktikave mësimore, internshipet) garanton mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p><i>RVB: Shënimet e vizitave;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, gjatë vizitës në institucion, vizitoi të gjitha këto ambiente dhe konstaton që ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke marrë në konsideratë numrin e studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit e moduleve përkatëse. Të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkekohore dhe që plotësojnë më së miri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira</i></p>

	të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuara. GVJ, mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion konstaton që IAL, kryesisht me kapacitetet që zotëron (laboratorë, studio) por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera (kryerjen e praktikave mësimore, internshipet) garanton mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e UAL ofron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës si me personel ashtu edhe online. Ajo ka në fondin e saj tekste mësimore bazë si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj. Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të U_POLIS. Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore por jo vetëm. Gjithashtu, të gjithë studentet e këtij programi kishin qasje të plotë në bibliotekën fizike por dhe në dy e-Libraritë dixhitale të U_POLIS: EBSCO dhe JSTOR. <i>RVB; Shënimet e vizitave Aneksi Nr.31-Literatura/Biblioteka</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Drejtuesi i fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi ishin shumë të angazhuar për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës. Kjo bëhej e mundur nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Buxhetit të Departamentit; • Donacioneve nga partnerë të ndryshëm; • Kontribute të projekteve EU (TEMPUS, Erasmus +) etj • Publikime/përkthime nga vete stafi i U_POLIS.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UAL ofron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës si me personel ashtu edhe online. Ajo ka në fondin e saj tekste mësimore bazë si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj.

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblio_POLIS është një nga qendrat kryesore të informacionit dhe kërkimit në universitet dhe pjesë përbërëse e njësisë kërkimore IKZH. Biblio_POLIS ka një fond aktual prej 10400 tituj/30 vende të ndryshme + E Library libra të printuar, në përputhje me programet që ofron, duke qënë kështu biblioteka më e pasur në vend për këto disiplina. Biblioteka ka inventarin e vet elektronik dhe në ambientet e saj ka një sërë kompjuterësh PC, ku studentet mund të kërkojnë në mënyrë të pavarur titujt që ju duhen përpara se ti drejtohen punonjësës së bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>POLIS disponon një bibliotekë me një hapësirë prej 155 m2, e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për të ofruar komoditet dhe akses të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët. Të dy libraritë dixhitale: EBSCO dhe JSTor ofrojnë qasje pa pagese për të gjithë komunitetin e POLIS: studente dhe staf.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ka inventarin e vet elektronik dhe në ambientet e saj ka një sërë kompjuterësh PC, ku studentet mund të kërkojnë në mënyrë të pavarur titujt që ju duhen përpara se ti drejtohen punonjësës së bibliotekës. Përpos hapësirave të lira ku studentët mund të lexojnë apo punojnë në kompjuterat personalë, biblioteka disponon edhe kompjutera të pajisur me programet kompjuterike të nevojshme për t'u ardhur në ndihmë studentëve të punojnë në mënyrë të pavarur për detyrat, projektet, etj apo për të studiuar. GVJ gjatë takimit me studentët u njoftuan se në procesin mësimor shfrytëzohen software profesional sikur janë AutoCAD, Revit, 3D software etj. Studentët gjatë gjithë kohës së studimeve përdorin edhe software-at profesional për Plaifikim Teritori dhe GIS të cilat ndihmojnë në rritjen e shpejtësisë dhe cilesisë së përgatitjes së detyrave e projekteve. <i>RVB; Shënimet e vizitave Aneksi Nr.39-Lista e projekteve.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës përkon me orarin e zhvillimit të mësimimit, si gjatë javës ashtu dhe në fundjave për programet profesionale. Biblioteka funksionon çdo ditë të javës (nga e hëna në të diel), përveç festave zyrtare, dhe është në shërbim të studentëve nga ora 08:30-17:00 <i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe</p>	<p>Përgjegjësit e Departamenteve në bashkëpunim me fakultetet dhe rektoratin angazhohen çdo vit akademik për të shtuar literaturën e bibliotekës duke e pasuruar atë me materiale cilësore dhe bashkëkohore në ndihmë të studentëve dhe stafit për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore në universitet. Njësia përgjegjëse e bibliotekës, informon nëpërmjet postës elektronike, stafin e brendshëm, atë të jashtëm dhe të gjithë studentët</p>

fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	e universitetit, për çdo titull të ri i cili regjistrohet në bibliotekë, duke dhënë informacion paraprak mbi titullin, disiplinën, dhuruesin dhe numrin e kopjeve të disponueshme në gjendje fizike. Njësia, mban raportim për çdo titull i cili huazohet nga bibliotekë, me sistem gjurmimi, dhe skeda elektronike dhe fizike për përdoruesit e saj. <i>RVB: Shënimet e vizitave</i>						
Konkluzione	<i>GVJ gjatë takimit me studentët konstatoam se në procesin mësimor shfrytëzohen software profesional sikur janë AutoCAD, Revit, 3D software etj. Studentët gjatë gjithë kohës së studimeve përdorin edhe software-at profesional për Planifikim Teritori dhe GIS të cilat ndihmojnë në rritjen e shpejtësisë dhe cilesisë së përgatitjes së detyrave e projekteve</i>						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="609 842 775 913">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="778 842 989 913">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="992 842 1177 913">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="609 913 775 949"></td> <td data-bbox="778 913 989 949"></td> <td data-bbox="992 913 1177 949" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					


Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	U_POLIS ka prej vitesh një sistem të menaxhimit elektronik të informacionit. Gjatë dy viteve të fundit sistemi i përdorur i platformës elektronike është Pitagora dhe studentet mund të i qasen nëpërmjet faqen elektronike të institucionit: https://polis.pitagora.rash.al/login . Në këtë platformë elektronike studentet mund të qasen informatave lidhur me lëndët (syllabusin), orarin, mungesat, notat, njoftime të ndryshme në kohë reale nga sekretaria mësimore, etj. <i>RVB: Shënimet e vizitave, Aneks Nr.21-Manualet e përdorimit të PITAGORES.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Pjesëmarrësit, të punësuarit e IAL, stafi akademik, administrativ etj. janë të informuar për strukturën e institucionit, ofertën akademike, cilësinë e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit etj. Ky informacion është i qasshëm nga studentët si tek faqja zyrtare e institucionit në web, në face book, në YouTube apo në twitter ashtu edhe pranë njësive strukturore të tilla si ZMSKK, NJSBC. Krahas stafit akademik dhe administratës edhe për studentët, sistemi mban të dhënat edhe për studentët (i cili gjithashtu logohet me kredencialet e tij personale). Në këtë portal stafi ka të dhënat e tij, përfshi kualifikimin akademik dhe ka mundësi të shfaq syllabusin e lëndës, të vendosë vlerësimin e studenteve, të evidentojë mungesat e tyre, etj. Studentët informohen edhe me të dhënat e grumbulluara nga të

	<p>diplomuarit lidhur me statistikat e punësimit, historitë e suksesit etj nëpërmjet broshurës ALUMNI.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave,</i></p>		
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Informacioni është njesoj i aksesueshem nga studentet dhe stafi vetëm për aspekte si rregulloret e institucionit, biblioteka dhe orari, kurse aspektet e tjera ndryshojnë. Edhe brenda personelit akademik varësisht pozicionit që mban secili staf ka qasje të ndryshme në të dhëna dhe mundësia për të gjeneruar raporte është i ndryshëm. Institucioni ka siguruar për punonjësit akademikë dhe jo akademikë infrastrukturën e nevojshme për pëmbushjen e detyrave të tij, si pajisje kompjuterike dhe shërbime interneti, pajisje të tjera të rëndësishme si printer, fotokopje, skaner, etj.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave</i></p>		
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Krahas sistemit të menaxhimit, U_POLIS ka dhe qasje institucionale të autorizuar në platformën Google Education, që është përdorur masivisht gjatë pandemisë: Google Classroom dhe Google Handouts për ndërveprimin e drejtpërdrejtë mes stafit dhe studentëve.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi është programuar që të mund të gjenerojë raporte të ndryshme si për stafin drejtues, akademik ashtu dhe për administratën e IAL.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave;</i></p>		
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Website i Universiteti POLIS është një faqe zyrtare publike e IAL që përmban informacion të detajuar për të gjithë aktivitetin e institucionit si dhe të gjithë programet e studimit që ai ofron. Faqja është dygjuhëshe: shqip dhe anglisht.</p> <p>www.universitetipolis.edu.al</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti Polis disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij. Këto raporte janë dhënë për të gjitha vitet akademike. Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare nga tarifat e studimit por edhe donacionet dhe bashkëpunimi me partner lokale dhe ndërkombëtarë.</p> <p>Ky buxhet vjetor është edhe pjesë e Raportit Vjetor që dorëzohet pranë MAS.</p> <p>GVJ konstatoi se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. Për më tepër hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e tillë që të shërbejë në një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave, Aneks Nr. 32-te dhena tabelare të kerkuara nga ASCAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion</p>	<p>Buxheti vjetor përmban një planifikim të detajuar financiar si të zërave të shpenzimeve (ku zëri paga për stafin akademik zë peshën më të madhe, shoqëruar me shpenzime materiale, operationale dhe në fund investime) ashtu dhe të burimeve të financimit. Diversifikimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime, duke pas parasysh që rritja e kostos së shkollimit në disa raste të mos kompensohet më rritjen e tarifës, dëshmojnë për kujdesin e veçantë ndaj cilësisë dhe dimensionin e përgjegjshmërisë sociale. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të infrastrukturës lehtësuese siç mund të jenë laboratorët. Eksperienca 15vjeçare e IAL në fushën e buxhetimit është e konsoliduar dhe parashikimi i buxhetit kryhet me saktësi shumë të</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga vizita u konstatua se monitorimi i aktiviteteve financiare kryhej rregullisht nga Bordi i Administrimit si dhe Asambleja e Ortakëve. Zyra e financës çdo vit hartonte bilancin vjetor. Për këtë qëllim ishte kontraktuar një kompani ndërkombëtare e specializuar (Mazars) konsulencë financiare e cila asistonte Zyrën e Financave për probleme dhe aspekte financiare si dhe nëpërmjet një eksperti kontabël të autorizuar kontrollonte dhe verifikonte bilancin vjetor të hartuar nga Zyra e Financave. Ky dokument i bashkëngjitet Raportit Vjetor që IAL harton dhe dorëzon në MAS.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>



Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës kjo duke u mbështetur edhe në planin e aktiviteteve të realizuar në nivel departamentit .		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Sipas RVB, POLIS synon të vazhdojë të punojë për diversifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit si një mënyrë për të minimizuar riskun e një luhatje të mundshme në numrin e studenteve të regjistruar. Mbështetur në analizën e kostove si më sipër, U_POLIS bën bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ky bilanc bëhet për çdo Program Studimi. Më tej, në funksion të nevojave dhe prioritetëve bëhet planifikimi i blerjeve dhe kryerja e tyre. GVJ u interesua lidhur me gjendjen financiare duke u referuar edhe tek asetet disponuese dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>RVB; Shënimet e vizitave, Aneks Nr. 32-te dhena tabelare të kerkuara nga ASCAL</i>		
Konkluzione	<i>GVJ u interesua lidhur me gjendjen financiare duke u referuar edhe tek asetet disponuese dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konstaton që studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga U_POLIS për regjistrimin e tyre si dhe e kanë të plotë dokumentacionin e paraqitur për regjistrim. Politikën, procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve, në Universitetin Polis, në programet e studimit që ofron, janë të përcaktuara në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi. Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të

	<p>institucionit. www.universitetipolis.edu.al. Në U_POLIS vlerësohen herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimi i tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave, Aneksi Nr. 15-Organigrama;</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga RVB dhe biseda me studentë dhe ish studentë u vu re që ata orientohen vazhdimisht nga Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), e cila i asiston dhe i ndjek studentët gjatë kohës së studimeve, si dhe nga kordinatori i programit duke I orientuar dhe sqaruar per proceset dhe procedurat gjate gjithë kohes se shtrirjes se programit studimor master professional ne planifikim e GIS. Informacioni i përgjithshëm mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxënit, akreditimet e programeve etj jepet me anë të Guidës së Studentit. Në guidën studentore përfshihen edhe detaje të kurrikulës akademike, kritere dhe kushte që studentët duhet të plotësojnë psh për kalimin nga një vit në tjetrin, etj.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në programin e integruar të studimit Master professional në “Plaifikim Teritori dhe GIS”, janë të hartuara dhe publikuara çdo vit akademik të aksesueshme për të gjithë të interesuarit, në bashkëveprim me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. GVJ konsultoi dokumentacionin lidhur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në këtë program të studimit dhe konstatoi që kriteri bazë është ai i notës mesatare.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhja e studentëve në programin Master professional në “Plaifikim Teritori dhe GIS” janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi. Nga dokumentacioni i ofruar si dhe nga takimi me studentët, GVJ mësoi që ata i njihnin dhe njëkohësisht për ta ishin të aksesueshme kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së Pranimeve, përpara çdo viti akademik publiku dhe të interesuarit udhëzohen në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> <p><i>RVB; Shënimet e vizitave, Aneksi Nr. 14-Guida e studentit, Aneks Nr 35-politika e marketingut.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>Universiteti Polis harton dhe publikon përpara çdo viti akademik, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit, të programit të</p>

akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	studimit, kuotat, mesatare minimale dhe kritere të tjera në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 dhe Urdhrit të përvitshëm të MASR për pranimet e studentëve, si dhe vendimit përkatës të përvitshëm të Senatit Akademik. <i>RVB; Shënimet e vizitave</i>		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Pranimi kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 dhe Urdhrit të përvitshëm të MASR për pranimet e studentëve, si dhe vendimit përkatës të përvitshëm të Senatit Akademik të Universitetit POLIS. <i>RVB; Shënimet e vizitave</i>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	IAL raporton se ofron bursa për kategori të ndryshme studentesh si bursat e ekselencës, ato për shtresat në nevojë, për fëmijët jetimë, për fëmijët romë, bursa për fëmijët e policeve të rene në detyrë, etj <i>RVB; Shënimet e vizitave ,Aneksi Nr.14-Guida e studentit, Aneks Nr 35-politika e marketingut.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ mësoi që studentet i njihnin dhe për ta ishin të aksesueshme kriteret, procedurat e pranimet dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se U_POLIS ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e Universitetit POLIS, rregulloren e Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit. GVJ vlerëson se ky informimin behet në forma alternative, fizikisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit Pitagora, nëpërmjet webit të universitetit. <i>RVB; Shënimet e vizitave, Aneksi Nr. 14-Guida e studentit</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ referuar takimit me drejtues të njësisë kryesore, rezulton se studentët në Universitetin POLIS kanë të drejtën të transferojnë studimet e tyre në degë të ngjashme edhe brenda U_POLIS, transferim që realizohet vetëm në fillim të vitit. Departamenti luan një rol të rëndësishëm në këtë informim të studentëve, por ky informacion

	sigurohet edhe nëpërmjet Webit të Universitetit, apo njoftimeve që dalin mbi datat e aplikimeve etj. <i>RVB; Shënimet e vizitave; www.universitetipolis.edu.al</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se në fillim të çdo semestri, pedagogët e lëndëve informojnë studentët për programin e lëndës, procedurat e kontrollit dhe skemën e vlerësimit në sezon si dhe detyrimet që kanë për studentët. <i>RVB; Shënimet e vizitave Aneks Nr 35-politika e marketingut, transparenca,. www.universitetipolis.edu.al</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se U_Polis, ka në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e programit, kriteret dhe procedurat e tezes se provimit perfundimtar të cilat janë të publikuara në web. <i>RVB; Shënimet e vizitave; Aneks. Nr7-rregullore e Diplomimit www.universitetipolis.edu.al</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga vizita në institucion, me përfaqësuesit e Zyres se Pranimeve dhe me Departamentin e Planifikimit dhe Menaxhimit Urban, mesuam që UPOLIS organizon ditë të hapura të dedikuara për secilin program mbi informimin e të interesuarve, përfshirë këtu edhe për programin e studimit të Masterit profesional në planifikim e GIS në Tiranë e qyteteve të tjera të vendit. Në këto ditë përveç programit kandidatët njihen nga afër me infrastrukturën e universitetit, ambientet laboratorike, kurrikulën e programit, avantazhet e studimit në POLIS, dhe akreditimin institucional etj., informacione të cilat i orientojnë ata të bëjnë zgjedhjet e duhura. Përveç Zyrës së Pranimeve, është gjithmonë i pranishëm edhe një përfaqësues akademik nga program i ofruar nga U_POLIS. <i>RVB; Shënimet e vizitave Aneks Nr 35-politika e marketingut, transparenca. www.universitetipolis.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se U_POLIS ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e Universitetit POLIS, rregulloren e Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike mbi programet e studimeve dhe modulet përkatëse nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit si materialeve të botuara (broshura, fletëpalosje etj), materialeve elektronike të aksesueshme në faqen zyrtare të U_POLIS.</p> <p>GVJ nga takimet me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët e programit master profesional ne planifikim e GIS ne koordinim me sekretarinë mësimore informojnë studentët në lidhje me strukturën e organizimit të programit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 4; Aneksi Nr. 6; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr. 36</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për strukturën e vitit akademik, për kalendarin e provimeve, për orarin mësimor. GVJ konstatoi se çdo pedagog gjatë javës së parë të çdo viti informon studentët për lëndën, syllabusin, temat literaturën dhe detyrimet akademike të çdo lëndë</p> <p><i>Aneksi Nr.36; RVB; Takimet e organizuara;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në zyrën e këshillimit të studentëve dhe asaj të karrierës rezulton se këto zyra zhvillojnë aktivitete për orientimin në tregun e punës, panairë, janë shumë aktive. Aktiviteti i kësaj zyre mbështetet në aktivitete të përshtatura me nevojat e studentëve sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve. GVJ konstaton se megjithëse studentet e këtij programi pergjithesisht jane te punesuar, IAL u ofron këshillim studentëve qe jane te interesuar per tu perfshire ne treguen e punes, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor. Informacione dhe këshillime konkrete lidhur me tregun e punës dhe kontaktimin me punëdhënësit potencialë, studentët i marrin nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës e cila funksionon në institucion si njësi strukturore dhe e pavarur nga pikëpamja operative.</p> <p><i>RVB:Aneksi Nr.36;</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës dhe takimeve kuptoi që informacioni në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe kreditet është i aksesueshëm edhe në faqen web për të informuar edhe studentët jashtë institucionit Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm PITAGORA disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Programin Master profesional në Planifikim territori dhe GIS. https://polis.pitagora.rash.al/login;</p> <p><i>RVB:Aneksi Nr.21; .</i></p>



lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.									
Konkluzione	<i>GVJ nga takimet me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët e programit master professional ne planifikim e GIS ne koordinim me sekretarinë mësimore informojnë studentët në lidhje më strukturën e organizimit të programit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet plotësisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Për ruajtjen e dokumentacionit si në letër ashtu edhe medium elektronik, U_POLIS ka sektorin e Protokoll-arshivës, Dokumentet e arkivuara (materialet mësimore e ato të kërkimit shkencor si dhe i gjithë shkresimi administrativo-burokratik) ruhen në dosje të veçanta të ndara në vite. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me sekretarinë, konstaton se U_POLIS harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Këto të dhëna mbahen manualisht nga sekretaria edhe në mënyrë elektronike në sitimin e informacionit PITAGORA. Në hard copy në regjistrat e verifikuar ne sekretari ishin: 1. Regjistri Themeltar 2. Regjistri i Notave 3. Regjistri i Diplomave https://polis.pitagora.rash.al/login <i>Aneksi Nr. 4; Aneksi Nr. 7;</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria dispononte statistika për studentët e regjistruar, të pezulluar dhe të larguar. Vendimet e largimit ishin pjesë e dosjes së studentit kurse në regjistrin themeltar ishte shënuar data e largimit ose diplomimit të studentit dhe referenca përkatëse. Të gjithë ishin të pajisur me numër matrikulimi. Po ashtu edhe tek dosja e studentit ishin të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar. <i>RVB; Aneks 32-tabela ASCAL;</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe	GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban, konstaton se U_POLIS lidhur me studentët e Programit Master professional ne Plaifikim Teritori dhe GIS ofron mundesine e gjenerimit automatik të të gjitha statistikave të kërkuara nga MASR

<p>duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>apo institucionet përkatëse, apo dhe nga vetë U_POLIS. IAL mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në çdo lëndë, regjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të çdo lënde në hard copy dhe në soft copy, hidhen edhe në regjistrat themeltar si dhe në sistemin elektronik të U_POLIS.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>IAL nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit disponon të gjitha të dhënat për studentët, të cilat përditësohen nga profili individual i përdoruesit. Të drejtën për të gjeneruar statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS, transferimet, largimet dhe të diplomuarit për çdo vit e kanë sekretaria mësimore dhe administratori i sistemit në U_POLIS. GVJ kishte në dispozicion nga IAL të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të cilat rezultojnë se janë pjesë e analizave periodike që departamenti bën apo raporteve vjetore në nivel institucioni. GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar. Rrjeti Alumni rezultoi se ishte krijuar prej shume vitesh në nivel institucioni dhe azhornohej me të dhëna çdo vit.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara;</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Universiteti disponon statistikën mbi cilësinë në hyrje të studentëve (mesatarja në hyrje, shkollat nga vijnë, si dhe me cilësinë në dalje të tyre, pra mesataret respektive në dalje, duke i krahasuar me ato në hyrje për të kuptuar më mirë ecurinë e procesit dhe nevojat për përmirësime nëse ka. Dekanati është njësia kryesore që merret me studimin dhe kuptimin e këtyre rezultateve me qëllim orientimin e programit në formën e duhur për ti ofruar studentëve një program sa më efikas dhe frutdhënës në aspektin profesional, lidhur mbi të gjitha, edhe me koherencën e kurrikulave në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu ZMSKK, periodikisht mban kontakte me Alumni-in, për të kuptuar shkallën e punësimit të studentëve, llojin e punësimit dhe specifika të tjera. Informacion ky që raportohet e përditësohet edhe në Raportin Vjetor ndaj MAS, përtej përdorimit të brendshëm. Kontaktet periodike me Alumni, japin feedback Zyres së Karrierës, e cila bëhet subjekt diskutimi edhe me Departamentin përkatës, për të zhvilluar instrumenta më të përditësuara në lidhje me orientimin e studentëve të sapodiplomuar në tregun e punës.</p> <p><i>RVB; Aneks 32-tabela -21,ASCAL;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban konstaton se U_POLIS lidhur me studentët e Programit të Integruar të Studimeve Master i Shkencave në “Planifikim dhe Menaxhim Urban” ofron komoditetin e gjenerimit automatik të të gjitha statistikave të kërkuara nga MASR apo institucionet përkatëse, apo dhe nga vetë U_POLIS</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Universiteti Polis parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Senati Studentor është i përfaqësuar nga student e të gjitha njësive akademike dhe nga ky grup kolegjal i studentëve delegohen qështjet me interes të IAL lidhur me studentët. Senati Studentor është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Nga biseda me përfaqësues nga kjo njësi u vu re angazhimi dhe aktivizimit i studentëve në aktivitete me veprimtari te ndryshme me qëllim promovimin dhe jetën aktive dhe sociale të studentëve. <i>RVB; Takimet e organizuara.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Senati Studentor, është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i Senatit Studentor është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtaritë akademike por dhe me ato jashtë akademike që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve. senati_studentor@universitetipolis.edu.al . Nga biseda me studentë përfaqësues të senatit, u vu re përfshirja e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje të caktuar, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Senatori i secilit vit zgjidhet me shumicë votash nga kolegët e tij dhe mban kontakt të vazhduar me koordinatoren e programit, shefin e departamentit, etj lidhur me problematika të ndryshme që i shqetësojnë. <i>RVB; Takimet e organizuara.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga takimet ne UPOLIS mesuam qe koordinatorja e programit dhe përfaqësues nga departamenti e dekanati zhvillojnë takime me studentët e Masterit Profesional në “Planifikim Terriori dhe GIS” me fokus ecurinë e semestrit; vlerësimin e kushteve laboratorike; nevoja për përmirësime bazuar në pritshmëritë Universitet/Studentë; marrje në shqyrtim të propozimeve të ardhura nga studentët mbi nevojën për rishikimin e kurrikulës. Propozimet e tyre diskutohen ne mbledhjet e departamentit gjate procesit te rishikimit dhe përditësimit të kurrikulave në masën e përcaktuar ligjërisht, sidomos çështja e

	lëndëve të reja që ata shikonin të nevojshme për formimin e tyre profesional. <i>RVB, Takimet e organizuara, Aneks 22-ZMSKK_Rregullore</i>						
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët e Programit të Masterit Profesional në “Planifikim Teritori dhe GIS” mund të shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorit nga sistemi për vlerësimin e pedagogut sipas mendimit të tyre. Kjo procedurë ndiqet dhe analizohet nga NJSBC. GVJ konstaton se studentët kanë të përcaktuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre <i>RVB; Takimet e organizuara.</i>						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët kanë të përcaktuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ, referuar RVB, mëson që IAL ka të ngritur një sistem funksional informacioni për të përcjellë tek studentët gjithë çfarë atyre u nevojitet në lidhje me programin e studimit MSc PMU: procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, rregulloren e provimeve, procedurat që lidhen me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor etj. GVJ konstaton se U_POLIS nëpërmjet njësisë të posaçme në strukturën organizative zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e U_POLIS. Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, NJSBC, Zyrës e mbështetjes së studentëve, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Alumni, Zyrës së Shërbimit të Studentëve, etj.. Në të gjitha këto takime GVJ u informua për aktivitetin e tyre në shërbim të studentëve
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me	U_POLIS ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, që kanë përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni siç është, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit

procesin mësimor dhe programin e studimit.	<i>RVB; Takimet e organizuara.</i>		
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës informon studentët me transparencë të plotë për çështjet dhe aspektet akademike, mësimore, si edhe me të drejtat dhe detyrat e tyre. Ajo orienton studentët drejt zgjedhjes së fushave specifike formuese sipas profilit të tyre dhe i njeh ata me mundësitë që universiteti ofron. Gjithashtu, informon studentët lidhur me tregun e punës dhe mundësitë që ai ofron, duke luajtur rolin e ndërmjetësit në këtë mes. http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57 <i>RVB; Takimet e organizuara</i>		
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ka bërë një studim më të hollësishëm mbi nivelin e punësimit, natyrën dhe përputhshmërinë e punësimit me formimin e përgjithshëm dhe specifik të çdo studenti, duke i ndjekur e mbajtur kontakte me ta edhe pas diplomimit. Orientojnë studentët për një përputhshmëri më të mirë me tregun që është gjithmonë në evolucion. http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57		
Konkluzione	<i>Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, NjSBC, Zyrës e mbështetjes së studentëve, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Alumni, Zyrës së Shërbimit të Studentëve, etj. Në të gjitha këto takime GVJ u informua për aktivitetin e tyre në shërbim të studentëve</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e	Universiteti POLIS, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme, ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë


metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	në “Rregulloren e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë” .Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627 (Aneks 8. Rregullore e NJBSC).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë monitoron proceset dhe vlerësimet periodike dhe të dhenat e raportuara nga studentet dhe stafi akademik, trajtohen në formën e gjetjeve dhe si të tilla pasqyrohen në formën e një raporti me qëllim analizimin e tyre, dhe marrjen e masave për rastet kur është e nevojshme. Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol edhe mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit. NJBSC ka zgjeruar vazhdimisht fushën e saj të veprimit dhe aktualisht mbulon jo vetëm procesin e mësimdhënies, por edhe funksionet kërkimore dhe administrative. <i>RVB, raportet e NJBSC Aneks 8. Rregullore e NJBSC, Aneks-2,4,18, 21).</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Studentet kanë mundësi që çdo fund simestri nëpërmjet një pyetsori të posaçëm, të realizuar nga sistemi Pitagora të vlerësojnë me pike dhe pershkrim me fjale mendimet e tyre për të gjitha lëndet e zhvilluara në atë semester. Konkluzionet e raporteve të NJBSC-së në lidhje me cilësinë janë bërë gjithmonë transparente, nëpërmjet mailit, prezantimit në Senatit Akademik, i cili në POLIS, organizohet si mbledhje e hapur për të gjithë stafin dhe përfaqësuesit e studentëve. Ndërsa gjetjet më të detajuara i përcillen secilit anëtar të stafit në fomë personale me mail të posaçëm. <i>RVB, raportet e NJBSC Aneks 8. Rregullore e NJBSC, Aneks-2,4,18, 21).</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Konkluzionet e raporteve të NJBSC-së në lidhje me cilësinë janë bërë gjithmonë transparente, nëpërmjet mailit, prezantimit në Senatit Akademik, i cili në POLIS, organizohet si mbledhje e hapur për të gjithë stafin dhe përfaqësuesit e studentëve. Ndërsa gjetjet më të detajuara i përcillen secilit anëtar të stafit në fomë personale me mail të posaçëm. Të dhënat dhe gjetjet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC si dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm Institucional që përgatitet në fund të çdo viti akademik, Raport i cili dërgohet në MAS dhe ASCAL.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në të dhenat e raporteve të NJBSC, përgatiten rekomandimet përkatëse për përmirësimin cilësor të procesit të mësimdhënies dhe monitorohet në vazhdimësi që këto rekomandime të vihen në zbatim nga njesite baze të UPOLIS. <i>RVB, raportet e NJBSC Aneks 34, Aneks 23.</i>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	IAL ka ngritur dhe stabilizuar prej vitesh sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe procedural. Sigurimi i cilësisë në programin Master professional ne Plaifikim Territori dhe GIS, ashtu si dhe në programet e tjera që ofron institucioni realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJBSC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të stafit akademik si dhe bashkëpunimi me struktura e fakultetit. Të gjitha politikat për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Dekanati dhe Senati Akademik. Ligji për arsimin e lartë; <i>RVB; Takimet e organizuara.; Aneksi Nr.8.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj synon konsolidimin e kulturës së cilësisë në universitet. Kjo njësi është e angazhuar për të promovuar përsosmërinë në manaxhimin dhe sigurimin e cilësisë nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore më të mira si dhe institucionalizimit të tyre bazuar në <u>Standartet Kombëtare të Cilësisë dhe Standartet Europiane të Sigurimit të Cilësisë</u> . Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit. NJSBC në Universitetin POLIS përbehet nga 9 anëtarë nga të cilët një student i diplomuar (Alumnus i POLIS) dhe i përfaqësues nga komuniteti i biznesit, institucion partner i POLIS në cilësinë e ekspertit të jashtëm që sjell perspektiven e tregut se bashku me studentin e diplomuar. <i>RVB; Takimet e organizuara, Aneksi 32; Aneks 8;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e	U_POLIS përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së

<p>duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Një nga proceset më të rëndësishme që i shërben institucionit për analizimin, reflektimin dhe përmirësimin e cilësisë janë proceset e akreditimit që na ka ndihmuar të kemi mundësi të përmirësojmë instrumentat vlerësuese dhe proceset e tjera të cilat përmirësojnë cilësinë. Gjithashtu projektet nderkombetare si, Projektit Erasmus +, Key Action 2, QainAL “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri”, kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e proceseve dhe cilësisë të mesimdhënis.</p> <p><i>(RVB; Takimet e organizuara, Aneks 8;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Procesi për përmirësimin e cilësisë është i rregulluar nëpërmjet procedurave periodike të hartuara dhe të përshtatura gjithashtu edhe me standartin ISO 9001:2015 .Disa nga proceset periodike të shtrira përgjatë një viti akademik të kësaj njësie janë:</p> <p>1.Procesi i vlerësimit të cilësisë së mesimdhënis të stafit akademik i përbërë nga 4 komponentë vlerësimi komplementarë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Vlerësimi nga studentët (pesha në vlerësimin total është 50% b) Vlerësimi nga kolegët (pesha në vlerësimin total është 35 %) c) Vetë-vlerësimi (pesha në vlerësimin total është 15%) d) Vlerësim nga drejtuesit <p>2.Vlerësimi i performancës akademike mbi angazhimin në punët kërkimore</p> <p>3.Hartimi i Raportit Vjetor të Përgjithshëm të NJBSC mbi cilësinë i cili përgatitet në fund të çdo viti akademik, (Aneks Raporti vjetor NJSBC) rezultatet e të cilit i bëhen të ditura stafit dhe studentëve nëpërmjet mbledhjes së hapur të Senatit Akademik.</p> <p>Të dhënat dhe gjetjet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC si dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm Institucional që përgatitet në fund të çdo viti akademik, Raport i cili dërgohet në MAS dhe ASCAL.</p> <p><i>RVB; Takimet e organizuara, Aneks 18;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.3




Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>I gjithë procesi i vlerësimit të mësimdhënies dokumentohet në raportin e NJSBC. Procese të tjera si propozime nga Alumni (nëpërmjet një pyetësi të posaçëm), ose minutat e takimeve të departamentit ku diskutohen përmirësime eventuale të programit janë gjithashtu të formalizuara dhe dokumentuara. Raporti Vjetor i Përgjithshëm i NJSBC mbi cilësinë përgatitet në fund të çdo viti akademik, (Aneks Raporti vjetor NJSBC) dhe rezultatet e tij i bëhen të ditura stafit dhe studentëve nëpërmjet mbledhjes së hapur të Senatit Akademik.</p> <p><i>RVB ,Aneksi Nr.34;</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raporti i NJSBC është i strukturuar dhe përmbanë të dhënat numerike por dhe interpretimin e tyre dhe rekomandimet që rezultojnë nga interpretimi i të dhënave të vlerësimit.</p> <p><i>RVB ,Aneksi Nr.34;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare,</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit institucioni përdor metoda të shumëllojshme, të drejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet e studenteve aktual dhe alumni, interesimet me shkrim dhe ne auditorë drejtpërdrejtë, ndjekja e ecurisë së studenteve, pjesëmarrje në mbrojtjen e diplomave, punësimi i tyre, opinionet mbi kurrikulen, mësimdhënien, rezultatet e të nxënit dhe orientimi i tyre në tregun e punës, etj. Në raste të veçanta bëhen sondazhe të posaçme për të tërhequr mendimin e studenteve, një shembull i përmendur gjatë vizitës ishte një sondazh i kryer gjatë pandemisë për cilësinë e organizimit të mësimit online si dhe ofrimin e shërbimeve të tjera ndaj studentit në kushtet kur administrata punonte nga shtëpia.</p> <p><i>RVB ,Aneksi Nr.34;</i></p>

si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.							
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj. Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit. Kjo tregon që institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Master professional ne planifikim e GIS, në kuadër të SBC-së. <i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.34</i>						
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni monitoron dhe vlerëson përmes njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Përsa i përket vlerësimit të cilësisë, krahas kontrollit nga ana e strukturave drejtuese, NJSBC përfshin në këtë proces stafin akademik dhe ndihmës të institucionit, studentet, një përfaqësues ALUMNI dhe një përfaqësues nga një institucion partner i POLIS si ekspert i jashtëm.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NjSBC në përbërje të	IALmbështetur në aktet ligjore dhe ato rregullatore ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NjSBC në përbërje të

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>së cilës ka aktorë të brendshëm, studentë dhe aktorë të jashtëm. Të dhënat e kërkuara dhe të siguruar nga kjo zyrë i vihen në dispozicion GVB i cili harton RVB. Gjatë takimit me NJSBC u kuptua që anëtarë të ndryshëm të njësisë ishin përgjegjës për komponentë të ndryshëm të vlerësimit (disa për mësimdhënien, disa për kërkimin, disa për administratën), kurse roli i Alumni dhe përfaqësuesit nga komuniteti I biznesit është sjellja e informacionit për zhvillimet e tregut dhe validimi I rekomandimeve për përmirësimin e programit. <i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.32-tabela nga ASCAL, tabela 24</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e gjithë materialeve të RVB si dhe në takimet gjatë vizitës në IAL, GVJ gjen që në sigurimin e cilësisë të këtij programi është garantuar dhe është realizuar përfshirja e njësisë bazë, Departamentit dhe kryesore FPMMU, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. Parë që komponentët e vlerësimit të mësimdhënies përfshijnë krahas vlerësimit të studenteve dhe vlerësimin nga koleget dhe nga eproret, përfshirja e njësisë baze dhe asaj kryesore garantohet</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe të sigurohet objektiviteti si nga ana e stafit ashtu dhe nga ana e studenteve, studentet e bëjnë vlerësimin për pedagoget në fund të lendes (pa filluar sezoni i provimeve). Ky vlerësim pedagoqeve iu behet i ditur vetëm pasi ata kane kryer vendosjen notave të studenteve. Në këtë mënyrë sigurohet që vlerësimi të jete i pa influencuar. Këto cilësi të të dhënave u konfirmuan edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion. Kjo dëshmon që përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit ka respektuar integritetin akademik dhe ka shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. <i>RVB; Takimet e organizuara Aneksi Nr.9, Aneks 10</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Konkretisht për këtë program studimi, krahas ekspertit të jashtëm anëtar i NJSBC, një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit jep rrejt i partnereve të Shoqatës së Shkollave Europiane të Planifikimit – AESOP, ku POLIS është anëtar aktiv dhe ka qenë subjekt vlerësimi për cilësinë e programit. Po ashtu nga vizita në institucion, GVJ mësoi që janë konsultuar edhe ekspertë të tjerë nga tregu i punës dhe nga partnerët bashkëpunues. Mendimet dhe sugjerimet janë konsideruar jo vetëm duke u përfshirë në RVB por edhe duke u realizuar konkretisht. <i>RVB; Aneksi Nr. 27</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se në institucion është e garantuar përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit dhe ka respektuar integritetin akademik, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përfundohet	Përfundohet kryesisht	Përfundohet plotësisht
			X
Standardi VI.5			
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit raporte me gjetjet e proceseve të vlerësimeve periodike që realizon. Këto raporte, krahas shpërndarjes me e-mail, prezantohen në mbledhje të Senatit Akademik, ku janë prezent i gjithë stafi dhe përfaqësia studentore, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim. GVJ, gjatë vizitës në institucion, në takim me përfaqësues të zyrave të NJSBC u njoh me veprimtarinë konkrete të kësaj zyre dhe konstaton që aktiviteti konkret i tyre synon dhe realizon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>RVB; Takimet e organizuara</i>		
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC përpunon të dhënat e marra nga formularët e vlerësimit dhe harton një raport të përmbledhur numerik të cilin e dorëzon në Rektorat. Në rast problematikash specifike kur kërkohet një informacion me i detajuar, informacioni që jepet ruan anonimitetin. Gjatë takimit me përfaqësues të zyrave të NJSBC dhe asaj të Kurrikulës dhe Cilësisë, GVJ u informua për të gjitha procedurat që ndiqen nga këto zyra për sigurimin e cilësisë, duke filluar me rishikimin e planeve mësimore, vlerësimin e mësimdhënies nga pedagogët nëpërmjet vizitave në klasa dhe intervistimit të tyre mbi cilësinë e programeve, angazhimin e studentëve nëpërmjet sondazheve mbi zhvillimin e provimeve etj. <i>RVB; Takimet e organizuara</i>		
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në rezultatet e procesit të vlerësimit, NJSBC-ja harton një raport me rekomandime për përmirësimet e mundshme në staf, në procesin e mësimdhënies, kurrikules, metodologjisë, etj.		
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e cilësisë i nënshtrohet dhe vetë një procesi vlerësimi. Studentët krahas mësimdhënies vlerësojnë dhe performancën e njësive të ndryshme administrative dhe mbështetëse në POLIS si Zyra e Mbështetjes së Karrierës, Sekretaria Mësimore, IT, etj. Pjesë e këtij vlerësimi është dhe NJSBC si një mënyrë për të matur efektivitetin dhe impaktin e aktivitetit të saj.		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për	Krahas përfshirjes së tyre aktive në procesin e sigurimit të cilësisë, NJSBC zhvillon një sere seminaresh trajnuese për staf dhe studente. Një pjesë e stafit trajnohet gjithashtu nga projekte të ndryshme		

informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Erasmus për aspekte të veçanta të cilësisë së mësimdhënies e mësim nxënies. <i>RVB; Takimet e organizuara, Aneks 53-njoftime për informim nga NJBSC</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, gjatë vizitës në institucion, në takim me përfaqësues të zyrave të NjSBC u njoh me veprimtarinë konkrete të kësaj zyre dhe konstaton që aktiviteti konkret i tyre synon dhe realizon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional
në Planifikim Territori dhe GIS ofruar nga ofruar nga Universiteti Polis**

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit *Masteri Profesional në "Planifikim Territori dhe GIS"*, është hartuar në përputhje me strategjinë, misionin, fokusin dhe objektivat e U_POLIS, dhe në përputhje me kërkesat e nevojat e tregut për këtë profesion të ri dhe në rritje. Ky program ndjek dhe zbaton parimet, ligjet dhe standardet e përgjithshme të traditës shqiptare e asaj europiane duke ofruar gjithashtu edhe origjinalitetin e programit të studimit në bazë të natyrës dhe specifikave të misionit të universitetit.
2. Programi ndërton cilësi të ofertës akademike duke garantuar nivele përtej standardit shqiptar, mbi përvojën unike që ky fakultet tashmë ka me programin e Masterit Profesional në "Planifikim Territori dhe GIS" (i ri-akredituar nga ASCAL në vitin 2018, dhe ristrukturuar nga Polis në 2021), si edhe përgjegjësi sociale ndaj shoqërisë që ka nevojë urgjente për këtë profil/ekspertizë në tregun aktual, kjo duke konsideruar kërkesat e legjislacionit të fushës, dhe anëtarësimin e Shqipërisë në BE, dhe me specifikisht nën direktivën INSPIRE, 2013.
3. Lidërshipi inovativ i U_POLIS – drejtuesit kanë kapacitete qeverisëse, organizative, koordinuese dhe janë të angazhuar e të përfshirë si edhe të ndërgjegjshëm në procesin e rritjes së standardeve në institucion, përmes një qasje holistike të investimeve në rritje dhe sigurimit të cilësisë, dhe përmirësimit të vazhdueshëm të saj.
4. Me zhvillimet institucionale të viteve të fundit, shtimin e stafit akademik efektiv dhe të ftuar, pasurimi dhe rritja e personelit me grada e tituj akademik në përputhje me standartet e kriteret shtetërore për këto programe studimit, hapja e programit ndërkombëtar të PhD, etj, rritja e infrastrukturës, dëshmon se U_POLIS kapacitetet akademike dhe shkencore për të ofruar me cilësi këto programe studimi specifike, jo vetëm në terma sasiorë por cilësor, e ka pike të fortë.
5. Marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes U-POLIS me universiteteve të tjera, veçanërisht të huaja, po i japin një hov të ri cilësisë akademike, kërkimore, dinamikës dhe vizibilitetit të institucionit si dhe dimensionit ndërkombëtar të tij. Bashkëpunimi me shoqatën europiane AESOP dhe me universitetet si: Universiteti Ferrarës, Universiteti Politeknik i Barit Itali; Universiteti i Minho, Portugali; Universiteti i shkencave të aplikuara, Anhalt, Gjermani; Universiteti i Molise-s, Itali; NTUA dhe Universiteti i West Attica, Greqi; Universiteti Politeknik, Bratislave, Slovaki; Universiteti i TU Viena Austri, etj, në këtë program studimi përbëjnë një garanci më shumë për cilësinë e edukimit të ofruar. Ndërkombëtarizimi do të jetë prioritet në rritje për Polis dhe programin në fjalë.
6. Programi i Studimit *Master Profesional në "Planifikim Territori dhe GIS"* ka një vëmendje të veçantë në Universitetin POLIS. Pas përfundimit të këtij programi, studentëve u ofrohet mundësia për zhvillimin e aftësive dhe njohurive me programe të tjera studimi siç është Programi Ndërkombëtar i Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban.

7. Universiteti POLIS është anëtar i Shoqatës Europiane të Shkollave të Arkitekturës AEEA dhe Shoqatës AESOP si dhe bashkëpunon me eCAADe. Prania e këtyre shoqatave jep një perspektivë dhe përvijë të mirë europiane, dhe ka ndihmuar njohjen e diplomave dhe transferimin e studimeve në BE dhe Amerikën e Veriut.
8. Prania në universitet, e Institutit Co-PLAN dhe Studios së Arkitekturës dhe Inxhinierisë “MetroPOLIS”, pasuron përvojat praktike të stafit dhe intershipet e studentëve në projekte konkrete. Universiteti POLIS ka bashkëpunime me aktorë në shoqëri dhe tregun e brendshëm. Bashkëpunimet me Shoqatën e Bashkive dhe pushtetin lokal materializohen me kontribute sociale ose me ekspertiza nga stafi dhe studentët e degës në fjalë. Këtu futen hartimet e planeve rregulluese, projekteve të ndërtesave publike, projektimin për rindërtimin e shkollave pas tërmetit, pjesëmarrje në konkurse ndërkombëtare, etj.
9. Programi ka një trashëgimi të shkëlqyer si një program në bashkëpunim me një shkollë europiane dhe në gjuhën angleze për gati një dekadë. Gjuha angleze është thujse gjuhë e dytë zyrtare në institucion.
10. U_POLIS garanton një nga infrastrukturat dhe standardet më moderne në vend përse i përket procesit akademik dhe kërkimor në fushat e planifikimit dhe arkitekturës, përfshirë këtu hapësirat, studiot dhe laboratorët e nevojshëm e specifikë për këtë program studimi si laborator i dedikuar për GIS/Cad, dhe sallat e studiove, dhe laboratorë të tjerë, te cilat janë në process dyfishimi deri në fund të këtij viti akademik.
11. Programi i studimit ka në dispozicion një bibliotekë të pasur me dy komponentë: *hard copy* dhe *soft copy*. Shkolla ka një bibliotekë fizike me mbi 10,000 tituj dhe 2 platforma të bibliotekës online, si dhe një platformë mësimdhënie online (Google Classroom) dhe sistemin e sigurimit të cilësisë dhe antiplagjiaturë Turnit-in që kanë garantuar qëndrueshmërinë e studimeve, dokumentimit dhe kërkimit gjatë momenteve të krizave si tërmetet, pandemia, etj.

b. Pikat e dobëta

1. Pjesëmarrja në Senatin Studentor si dhe organizmat e tjerë kolegiale të U_POLIS është relativisht e ulët dhe kjo sepse një përqindje e lartë të studentëve të këtij programi janë në marrëdhënie pune, por edhe si rezultat i kohës të zgjatur të programit të studimit (1.5 vite për 60 kredite). Kjo ndikon edhe në pjesëmarrjen e ulët të studentëve në aktivitete extra-kurrikulare, apo ato rekreative dhe sociale të organizuara nga universiteti.

c. Rekomandime

1. Institucionit, të rrisë përpjekjet për të rritur pjesëmarrjen në Senatin Studentor si dhe organizmat e tjerë kolegiale të U_POLIS të studentëve të këtij programi, si edhe në pjesëmarrjen e tyre në aktivitete extra-kurrikulare, apo rekreative dhe sociale të organizuara nga universiteti.

2. Të komunikohet me Drejtorinë e Administratës Publike për të përmirësuar njohjen dhe pikësimin e këtij programi për punonjësit e administratës publike, sidomos kur studentët kanë kryer më parë një program MSc ose MSc të Integruar, kjo ka rëndësi si për programin dhe për studentët.

Conclusions of the evaluation of the second cycle study program Professional Master in “Territory Planning and GIS” of the University Polis

a. Strengths and Affirmations:

1. The Professional Master's study program in "Territory Planning and GIS" has been designed in accordance with the strategy and mission, focus and objectives of U_POLIS, and in accordance with the demands and needs of the market for this new and growing profession. This program follows and implements the principles, laws and general standards of the Albanian and European tradition while also offering the originality of the study program based on the nature and specifics of the university's mission.
2. The program builds the quality of the academic offer by guaranteeing levels beyond the Albanian standard, on the unique experience that this faculty already has with the Professional Master's program in "Territory Planning and GIS" (re-accredited by ASCAL in 2018, and restructured by Polis in 2021), as well as social responsibility towards the society that urgently needs this profile/expertise in the current market, this considering the requirements of the legislation in the field, and Albania's membership in the EU, and more specifically under the INSPIRE directive, 2013.
3. The innovative leadership of U_POLIS - leaders have governance, organizational, coordination capacities and are engaged and involved as well as conscious in the process of raising standards in the institution, through a holistic approach of investments in growth and quality assurance, and its continuous improvement.
4. With the institutional developments of recent years, the addition of effective and invited academic staff, the enrichment and increase of staff with academic degrees and titles in accordance with the state standards and criteria for these study programs, the opening of the international PhD program, etc. the growth of the infrastructure proves that U_POLIS has strong academic and scientific capacities to provide these specific study programs with quality, not only in quantitative but qualitative terms.
5. The cooperation agreements concluded between U-POLIS and other universities, especially foreign ones, are giving a new boost to the academic quality, research, dynamics and visibility of the institution as well as its international dimension. Cooperation with the European association AESOP and with universities such as: University of Ferrara, Polytechnic University of Bari Italy; University of Minho, Portugal; University of Applied Sciences, Anhalt, Germany; University of Molise, Italy; NTUA and University of West Attica, Greece; Polytechnic University, Bratislava, Slovakia; The University of TU Vienna Austria, etc., in this study program constitute one more guarantee for the quality of the education offered. Internationalization will be a growing priority for Polis and the program in question.

6. The Professional Master Study Program in "Territory Planning and GIS" has a special focus at POLIS University. After completing this program, students are offered the opportunity to develop skills and knowledge with other study programs such as the International Doctoral Program in Architecture and Urban Planning.
7. POLIS University is a member of the European Association of Schools of Architecture AEEA and the AESOP Association and cooperates with eCAADe. The presence of these associations gives a good European perspective and experience, and has helped the recognition of degrees and the transfer of studies in the EU and North America.
8. The presence at the university of the Co-PLAN Institute and the "MetroPOLIS" Architecture and Engineering Studio enriches the practical experiences of the staff and student internships in concrete projects. POLIS University has collaborations with actors in society and the domestic market. Collaborations with the Association of Municipalities and local government are materialized with social contributions or with expertise from the staff and students of the department in question. This includes the drafting of regulatory plans, projects of public buildings, the design for the reconstruction of schools after the earthquake, participation in international competitions, etc.
9. The program has an excellent heritage as a program in cooperation with a European school and in the English language for almost a decade. English is almost the second official language in the institution.
10. U_POLIS guarantees one of the most modern infrastructures and standards in the country in terms of the academic and research process in the fields of planning and architecture, including the spaces, studios and laboratories necessary and specific for this study program such as a dedicated laboratory for GIS/Cad, and study halls, and other laboratories, which are in the process of doubling until the end of this academic year.
11. The study program has available a rich library with two components: hard copy and soft copy. The institution has a physical library with over 10,000 titles and 2 online library platforms, as well as an online teaching platform (Google Classroom) and quality assurance and anti-plagiarism system.


b. Weaknesses:

1. Participation in the Student Senate as well as other collegiate bodies of U_POLIS is relatively low and this is because a high percentage of students in this program are in employment, but also as a result of the extended time of the study program (1.5 years for 60 credits). This also affects the low participation of students in extra-curricular activities, or recreational and social activities organized by the university.

c. Recommendations:

1. The institution, to increase its efforts to increase the participation in the Student Senate as well as other collegiate bodies of U_POLIS of the students in this program, as well as in their participation in extra-curricular, or recreational and social activities organized by the university.
2. The institution, to communicate with the Directorate of Public Administration, to improve recognition and scoring of this program for public administration employees, especially when

students have previously completed an MSc or Integrated MSc program, this is important for both the program and the students.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

